



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 31/2024 regjistër (JR)  
Datë 30.07.2024

Nr. 2 i vendimit  
Datë 14.01.2026

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Ina Rama</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Relatore</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 14.01.2026, ditën e mërkurë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Inva Hasho, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Petref Asllani, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 761, datë 14.05.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; Nenet 62, 63, 65 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Nenet 46, 50 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

## **Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

### **VËREN:**

#### **I. Rrethanat e çështjes**

1. Subjekti i rivlerësimit Petref Asllani (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”) dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”). Komisioni, pas kryerjes së hetimit administrativ, me vendimin nr. 2, datë 15.04.2024, vendosi të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Petref Asllani për të tri kriteret e vlerësimit.

**2.1. ILDKPKI-ja,** pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë<sup>1</sup> së subjektit të rivlerësimit Petref Asllani, duke konkluduar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;* (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;* (iii) *ka kryer fshehje të pasurisë;* (iv) *ka kryer deklarim të rremë;* (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

#### **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

3. Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit:
  - a) për sa i takon kriterit të pasurisë, nuk arrin nivelin kualifikues, pasi ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme, sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra;
  - b) ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, sipas nenit 59/b të ligjit nr. 84/2016;
  - c) ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59/c të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>1</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 27.09.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit Petref Asllani, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”.

Komisioni, me vendimin nr. 761, datë 14.05.2024, vendosi: “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Petref Asllani, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan [...]*”.

### **III. Shkaqet e ankimit**

4. Kundër vendimit të Komisionit, në datën 24.07.2024, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), duke parashtruar shkaqe që lidhen me procesin e rregullt ligjor dhe kriterin e vlerësimit të pasurisë, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, duke kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 761, datë 14.05.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, në vlerësim të tri kriterëve të rivlerësimit.

#### **4.1. Në lidhje me procesin e rregullt ligjor subjekti i rivlerësimit pretendon se:**

i) Vendimi i Komisionit është marrë në vlerësim jo të drejtë të fakteve dhe provave të administruara e në zbatim të gabuar të legjislacionit të zbatueshëm duke bërë të vihet seriozisht në dyshim fakti se është gjykuar apo jo nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

ii) Subjekti pretendon se çdo pasuri e deklaruar prej tij ka qenë objekt i hetimit penal, në kuadër të procedimit penal nisur nga një kallëzim penal abuziv i ILDKPKI-së dhe më pas një vendimi pafajësie dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit, lënë në fuqi me vendimin përfundimtar të Gjykatës së Lartë. Sipas subjektit, Komisioni duke marrë rolin e kontrollorit të drejtësisë, me vendimarrjen e tij ka cenuar parimin e sigurisë juridike dhe gjësë së gjykuar.

iii) Sipas subjektit, vendimi i Komisionit përmban elemente të theksuara të paragjyqimit dhe duket i paracaktuar, pasi nuk është marrë në konsideratë asnjë argument dhe provë e paraqitur prej tij; nuk është arsyetuar në vendimin përfundimtar në lidhje me shpjegimet e tij se çdo burim i të ardhurave është provuar me burim të ligjshëm dhe në kundërshtim me praktikën e Komisionit dhe të Kolegjit. Vetë konstatimi i ILDKPKI-së se ai ka burime të ligjshme të pasurisë që justifikojnë pasuritë e vëna prej tij e vërteton këtë fakt.

iv) Konkluzioni i Komisionit *se shpjegimet/deklarimet e subjektit kanë qenë joshteruese dhe jo në koherencë me deklarimet ndër vite dhe atë vetting, dhe si rrjedhojë ky qëndrim i tij është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016*, është i pabazuar, pasi shpjegimet e tij kanë qenë në përputhje me sa ka deklaruar në deklarimet periodike dhe gjatë hetimit penal, nuk ka kryer deklarim të rremë apo fshehje të pasurisë apo të burimeve nga janë krijuar pasuritë.

v) Komisioni nuk ka respektuar parimin e proporcionalitetit, sikurse e kërkon ligji nr. 84/2016, pasi edhe nëse kjo mënyrë e plotësimit të deklaratave periodike do të vlerësohej e pasaktë, kjo do të ishte e paqëllimshme dhe nuk mund të barazohet me institutin e fshehjes së pasurisë, sikurse kërkohet nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, që të përbëjë deklarim të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61, pika 3 e këtij ligji dhe, për pasojë, shkak për shkarkimin nga detyra.

**4.2. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti paraqiti në ankim pretendimet si vijon.**

i) *Për pasurinë apartament banimi, sip 77,8 m<sup>2</sup>, lagjja “{\*\*\*}”, Elbasan, Komisioni në mënyrë të padrejtë ka përlllogaritur si çmim të blerjes së kësaj pasurie vlerën prej 50.000 eurosh, duke kërkuar nga Kolegji që të përfshijë në analizë vlerën e përcaktuar në kontratën e shitjes, datë 25.09.2012, shumën prej 3.821.526 lekësh. Subjekti pretendon se nëse do të kishte për qëllim të fshihte vlerën e apartamentit dhe të deklaronte një çmim fiktiv blerjeje nuk do ta kishte paraqitur dhe dorëzuar deklaratën noteriale të cilës i referohet Komisioni. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në lidhje me vlerën 50.000 euro, të përmendur në deklaratën e datës 04.06.2012, kjo shumë nuk i përket vetëm blerjes së apartamentit të tij nr. {\*\*\*}, por edhe blerjes së një apartamenti me nr. {\*\*\*}, të pretenduar nga vëllai i tij P. A..*

ii) *Lidhur me pasurinë apartament, lagjja “{\*\*\*}”, Elbasan, deklaruar si burim për apartamentin në lagjen “{\*\*\*}”, subjekti i rivlerësimit, duke kundërshtuar konkluzionet e Komisionit si të pabazuara dhe të gabuara, kryesisht mbështet ankimin e tij, duke dhënë interpretime të fakteve dhe rrethanave të ndodhura në atë periudhë, sipas variantit të paraqitur prej tij edhe në relacionin shpjegues, të cilin e ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, lidhur me mënyrën e përfitimit të shumave nga transaksionet e kryera mbi këto pasuri. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka sqaruar rrethanat se si ai ka përfituar shumën prej 3.345.117 lekësh, nga shitja e kësaj pasurie, megjithëse nuk ishte palë në kontratën e shitblerjes së apartamentit midis shitësit Q. H. dhe blerësit B. R. dhe arsyet se përse të ardhurat nga shitja e apartamentit të mësipërm nga Q. H. (shitësi) i janë dhënë atij.*

iii) Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që në analizën e tij financiare: (a) çmimi i blerjes së pasurisë apartament në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, në vitin 2000, të llogaritet në vlerën 300.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes dhe jo në vlerën 2.258.000 lekë, sikurse e ka llogaritur Komisioni; (b) të përfshijë në analizë vlerën prej 3.345.117 lekësh, e përfituar nga shitja e pasurisë së shtetasit Q. H.; (c) të përfshihen të ardhurat e siguruara nga shitja e apartamentit të vëllait Q. A., si dhe shuma e kursimeve prej 300.000 lekësh, dhuruar nga familja e origjinës; (ç) gjendja *cash* në fund të vitit 2003 duhet të përlllogaritet në shumën 742.000 lekë aq sa kanë qenë kursimet nga të ardhurat deri në fund të vitit 2003; (d) gjendja *cash* në fund të çdo viti duhet të përfshihet sipas tabelës së paraqitur prej tij në prapësimet e dorëzuara në Komision; (dh) shpenzimet e jetesës deri në vitin 1999 duhet të përfshihen në masën 30% të të ardhurave, pasi të ardhurat vjetore kanë qenë mbi 800 USD në vit; (e) çmimi i blerjes së apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, në vitin 2012, duhet të përlllogaritet në shumën 3.821.526 lekë.

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

##### **A. Aspekte procedurale**

###### *a) Mbi juridiksionin e Kolegjit*

5. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim që ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Petref Asllani,

bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016

*b) Mbi legjitimitimin e ankuesit*

6. Ankuesi Petref Asllani, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka ushtuar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe, në zbatim të nenit F, pika 2 e Kushtetutës, legjitimohet *ratione personae* për të ankimuar vendimin e Komisionit. Bazuar në nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor 15-ditor nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit dhe subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione temporis*.

*c) Mbi formën e gjykimit të ankimit*

7. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur ndaj vendimit të Komisionit ushtrohet ankim nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Në këndvështrim të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe të pretendimeve të paraqitura në ankim<sup>2</sup> nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit nuk evidentoi ndonjë shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike, në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, ~~i ndryshuar~~, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në Kolegj në seancë publike për korigjimin e tyre, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, dhe vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, ~~i ndryshuar~~.

**B. Vlerësimi i pretendimeve të subjektit mbi aspektet procedurale dhe procesin e rregullt**

8. Lidhur pretendimin e subjektit të rivlerësimit *se vendimi i Komisionit është marrë në vlerësim jo të drejtë të fakteve dhe provave të administruara e në zbatim të gabuar të legjislacionit të zbatueshëm, duke bërë të vihet seriozisht në dyshim fakti se është gjykuar apo jo nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi i Komisionit përmban elemente të theksuar të paragjykimin dhe duket i paracaktuar, pasi nuk është marrë në konsideratë asnjë argument dhe provë e paraqitur prej tij, nuk është arsyetuar në vendimin përfundimtar në lidhje me shpjegimet e tij se çdo burim i të ardhurave është provuar me burim të ligjshëm*, trupi gjykues konstaton se ky pretendim rezulton të jetë i përgjithshëm, i paargumentuar në detaje, me fakte dhe prova konkrete e, në këto kushte, trupi gjykues e analizoi atë në nivel parimor, sipas parashikimeve të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016.

**8.1.** Trupi gjykues nga analizimi i vendimit objekt ankimi konstaton se ai përmban të gjitha elementet e përcaktuara shprehimisht nga ligji e konkretisht, rrethanat e çështjes, analizën e provave dhe arsyetimin mbi të cilat mbështetet vendimi, rekomandimin e relatorit/relatores, konkluzionet e trupit gjykues, sikurse edhe dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi.

---

<sup>2</sup> Subjekti nuk depozitoi prova të reja bashkëlidhur ankimit.

Gjykata Kushtetuese ka theksuar në jurisprudencën e saj se argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara, të lidhura logjikisht dhe të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Në vendimin e Komisionit, për vlerësimin e kriterit të pasurisë, për cilëndo nga pasuritë e hetuara, janë përmbushur të gjitha urdhërimet ligjore të sipërcituara, përfshirë edhe dispozitat përkatëse ku është bazuar konkluzioni i Komisionit për secilin rast. Nga aktet në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pas përmbylljes së hetimit administrativ, Komisioni u ka dhënë përgjigje pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në zbatim të normave ligjore që lidhen me të provuarit për gjendjen e fakteve dhe rrethanave e çështjes, me vendim përfundimtar të arsyetuar, referuar dispozitave materiale të ligjit nr. 84/2016. Gjatë gjithë procesit nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë argumentuar apo parashtruar ndonjë fazë veprimesh që përbëjnë ndonjë cenim të të drejtave të tij procedurale, përfshirë ato për të paraqitur shpjegime, pretendime dhe prova. Ky pretendim i tij, me referencë cenimin e procesit të rregullt ligjor, rezulton të jetë ngritur për herë të parë në ankim.

**8.2.** Po ashtu, në jurisprudencën e saj, GjEDNj-ja ka arsyetuar se ndërsa neni 6, paragrafi i parë i KEDNj-së i detyron gjykatat të japin vendime të arsyetuara, kjo nuk duhet të kuptohet si detyrim për të dhënë përgjigje të detajuara për çdo argument, për sa kohë pretendimet kryesore të palëve janë trajtuar<sup>3</sup>. Siç është shtjelluar më sipër, pretendimi i subjektit për problematika me vendimin e Komisionit si mungesë arsyetimi apo njëanshmëri e paragjykim, nga kjo analizë e kryer nën dritën e dispozitave ligjore dhe standardeve të vendosura e zhvilluara nga GjEDNj-ja mbi bazën e nenit 6 të Konventës, rezulton i pabazuar dhe lidhet me vlerësimin që Komisioni u ka bërë shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, në raport me faktet që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ.

**8.3.** Trupi gjykues, nga përmbajtja e vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, konstaton se ky organ, për çdo çështje të trajtuar, ka referuar shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, duke dhënë edhe vlerësimin që Komisioni ka bërë lidhur me to. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se fakti që provat dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti Komisioni nuk i ka konsideruar të mjaftueshme për të ndryshuar rezultatet e hetimit administrativ, nuk tregon se ky organ nuk i ka konsideruar ato, por që ka pasur një vlerësim të ndryshëm nga ai i pritshëm prej subjektit të rivlerësimit. Për pasojë, vlerësohet se vetë përmbajtja e arsyetimit të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, provon se ky pretendim i subjektit është i pambështetur në situatën faktike.

**8.4.** Komisioni ia ka nënshtruar vlerësimin të tij provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, duke mbajtur qëndrim mbi vlerën provuese të akteve të sjella prej subjektit të rivlerësimit, atyre të cilat janë çmuar prej tij, me ndikimin apo efektin që ato kanë mbi çështjet e ngritura, në zbatim të parimit të parashikuar nga neni 81 i Kodit të Procedurave Administrative<sup>4</sup>.

**8.5.** Kuadri ligjor i procesit të rivlerësimit garanton që ushtrimi i funksioneve nga institucionet e rivlerësimit të bëhet mbi bazën e pavarësisë, paanësisë, barazisë përpara ligjit, të

<sup>3</sup> Përkatësisht, në *Van de Hurk kundër Holandës, paragrafi 61 dhe Buzescu kundër Rumanisë*.

<sup>4</sup> Sipas së cilit organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, si dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor<sup>5</sup>. Në kushtet kur subjekti nuk ka evidentuar asnjë situatë konkrete që mund të argumentohet se përbën njëanshmëri apo të ketë parashtruar se cilat rrethana kanë përbërë indicie për paragjykim, diskriminim apo keqdashje, duke pasur parasysh edhe faktin që këto pretendime ngrihen për herë të parë e pa asnjë ilustrim faktik në ankim, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara dhe janë përpjekje për të kontestuar vendimmarrjen në themel të Komisionit, nëpërmjet cilësimeve me natyrë procedurale.

9. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka cenuar parimin e sigurisë juridike dhe gjësë së gjykuar, pasi çdo pasuri e deklaruar prej tij ka qenë objekt i hetimit penal në kuadër të procedimit penal dhe më pas është dhënë një vendim pafajësie nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit, lënë në fuqi me vendimin përfundimtar të Gjykatës së Lartë, trupi gjykues çmon të theksojë se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës, e cila presupozon, veç të tjerave, besueshmërinë e qytetarëve të shteti dhe pandryshueshmërinë e vazhdueshme të ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Parimi i sigurisë juridike, përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ edhe besimin të sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situatë të favorshme ligjore.

9.1. Me qëllim analizimin e këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues, pasi kontrollon dokumentacionin e ndodhur në dosje, konstaton se në Komision janë administruar disa akte shpresore që i përkasin kallëzimit penal të ILDKPKI<sup>6</sup>-së ndaj subjektit të rivlerësimit, pikërisht në lidhje me shitjen e pasurisë të ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, konkretisht:

a. ILDKPKI-ja në vitin 2014 ka paraqitur një kallëzim penal ndaj subjekteve Q. H. (gjyqtar) dhe Petref Asllani (prokuror). Subjekti i rivlerësimit Petref Asllani është kallëzuar nga ky institucion për: (1) deklaram të rremë, në deklaratën para fillimit të detyrës dhe në deklaratat periodike vjetore për vitet 2004-2013, i likuiditetit në gjendjen *cash* në shumën 3.000.000 lekë me burim krijimi nga shitja e apartamentit, kur *de facto* kjo shumë e përfitur nga “shitja” e apartamentit është disponuar nga z. H.; (2) fshehje, në deklaratën periodike vjetore 2010, e përfitimit të shumës prej 3.345.117 lekësh nga shitja reale e apartamentit në datën 30.07.2010; (3) mashtrim në bashkëpunim me subjektin Q. H..

b. Nga aktet<sup>7</sup> e administruara gjatë hetimit administrativ, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Petref Asllani dhe një tjetër subjekti, Q. H., procedimin penal nr. {\*\*\*} i vitit 2015, të akuzuar për kryerjen e veprës penale të “*Refuzimi për deklaram, mosdeklaram, fshehja ose deklarami i rremë ia pasurisë, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose çdo personi tjetër që ka detyrimin për deklaram*”, të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, dhe se ndaj subjektit Petref Asllani, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranës, më datë 08.05.2015, ka dhënë

<sup>5</sup> Shih vendimet e Kolegjit nr. 26/2020 (JR), nr. 29/2020 (JR), nr. 4/2021 (JR) dhe nr. 19/2021.

<sup>6</sup> Shih dokumentin në aneksin 37 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>7</sup> Shih dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. {\*\*\*}prot., datë 19.11.2021, nga KLP-ja në dosjen e Komisionit.

masën e sigurimit “pezullim nga detyra, përkohësisht deri në përfundim të hetimit dhe gjykimin të çështjes penale”.

c. Në përfundim të gjykimin të çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.05.2016, ka vendosur deklarin e pafajshëm të të pandehurit Petref Asllani për veprën penale (si më sipër) të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, pasi fakti nuk përbën veprën penale. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 13.07.2017. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.02.2023, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë edhe nga i pandehuri Q. H..

**9.2.** Në kuadër të sa më lart, trupi gjykues, duke analizuar objektin për të cilin ka filluar procedimi penal ndaj subjektit të rivlerësimit, vëren se evidentohet qartësisht ekzistenca e elementeve që u përkasin qëllimeve të ndryshme midis procesit të rivlerësimit dhe procesit penal, si edhe parashikueshmëria e tyre ligjore dhe praktike. Sikurse konstatohet, objekti i procedimit penal lidhet me refuzimin për deklarin, fshehje dhe deklarin të rremë të pasurisë. Konkretisht, në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në pjesën mbyllëse të tij, ndër të tjera, citohet se: “Gjykata vëren se pavarësisht se nuk ka specifikuar burimin e kësaj shume në deklaratën e tij, i pandehuri e ka deklaruar atë në mënyrë të saktë, çka do të thotë se nuk mund të bëhet fjalë për fshehje apo deklarin të rremë të pasurisë”. Ndërsa nga leximi harmonik i parimeve mbi të cilat kryhet kontrolli i pasurisë së subjekteve në procesin [administrativ] të rivlerësimit, përveç se kërkohet identifikimi i qartë i burimit të krijimit të pasurisë, për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, sipas nenit D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016<sup>8</sup>, qëllimi është të identifikojë subjektet që kanë në pronësi ose përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Ky objektiv realizohet bazuar në parime dhe standarde të përcaktuara qartë.

**9.3.** Trupi gjykues, bazuar edhe nën dritën e jurisprudencës së GjEDNj-së<sup>9</sup>, sipas së cilës procedurat administrative dhe penale janë konsideruar thelbësisht të ndara dhe pa një lidhje materiale dhe kohore ndërmjet tyre, vëren se, në rastin konkret, procedurat e kryera janë ndjekur nga institucione të ndryshme, me tagra të ndryshme, mbi baza ligjore të ndryshme dhe natyrë tejet të ndryshme procedimesh. Mes dy procedimeve nuk ka asnjë lidhje, përpos që njëri është penal e tjetri administrativ – organet e rivlerësimit hetojnë dhe vendosin mbi kriteret të përcaktuara nga Kushtetuta e ligji në një proces autonom dhe me dinamikë e parime të ndryshme nga ato që karakterizojnë procedimin penal që kryen prokuroria. Ndjekja penale e ushtruar nga prokuroria ka në themel të saj parimin se barrën e provës për të provuar akuzën penale e ka organi procedues dhe i takon atij që, tej çdo dyshimi, të provojë ekzistencën e veprës penale dhe fajësinë e të pandehurit, rrethanë që duket se nuk ka ndodhur në procesin penal të kryer ndaj subjektit të rivlerësimit. Ndërsa, procesi i rivlerësimit mbështetet në baza krejt të ndryshme dhe përjashtimore, pasi barrën e provës për të provuar faktet e deklaruara e ka subjekti i rivlerësimit. Në këtë kuptim, fakti që prokuroria nuk ka arritur të provojë akuzën

<sup>8</sup> “Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.”

<sup>9</sup> Shih vendimet e GjEDNj-së, çështjet Häkkä k. Finlandës, Nykänen k. Finlandës, Glantz k. Finlandës, Rinas k. Finlandës, Österlund k. Finlandës, Kiiveri k. Finlandës dhe Lucky Dev k. Suedisë.

e ngritur prej saj, në procesin penal, nuk konsiderohet se krijon *ipso lege* e, për shkak të parimit të sigurisë juridike, provueshmërinë e deklarimeve të subjektit për të njëjtat rrethana. Në këtë kuptim, pavarësisht konkluzioneve të gjykatës penale mbi faktet objekt akuze, subjekti nuk ishte i zhveshur në procesin e rivlerësimit nga barra e provës për të provuar deklaratimet e tij në përputhje me parashikimet e nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Për këtë arsye, argumentet e subjektit për të kontestuar legjitimitetin e vlerësimit pasuror të kryer nga organet e rivlerësimit janë të pabazuara.

**9.4.** Trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje edhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka vënë në dukje elemente konkurruese me këtë parim. Konkretisht, interesi publik konkurren me sigurinë juridike dhe prevalon ndaj tij, sikurse referuar më sipër, arsyetuar gjerësisht edhe në jurisprudencën e GjEDNj-së, si dhe të Gjykatës Kushtetuese<sup>10</sup>. Procesi i rivlerësimit ka qenë derivat direkt i nevojës për të shëruar problemet endemike të kulturës së pandëshkueshmërisë së ndërsjellë që kishte zënë vend në sistemin e drejtësisë shqiptare<sup>11</sup>, referuar edhe nga Komisioni i Venecias në analizën e draft ndryshimeve kushtetuese që passollën edhe rivlerësimin. Në konsideratë të sa më sipër, juridiksionet e ndryshme, procedimet e ndjekura veçmas e në mënyrë të pavarur dhe të synimit për të cilin është ngritur sistemi i rivlerësimit, si garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, i bëjnë pretendimet e ngritura nga subjekti për cenim të sigurisë juridike të pabazuara.

**9.5.** Gjithsesi, duke vlerësuar në tërësi rrethanat të cilat i referohen analizës së shkakut të ankimit, trupi gjykues, në konsideratë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me konkluzionet e dala nga vendimi penal i sipëranalizuar, kreu një vlerësim të burimeve të krijimit të pasurisë apartament të ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, edhe duke llogaritur si burim të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit të ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, sërish subjekti nuk superoi testin e besueshmërisë së krijimit të pasurisë me burime të ligjshme, duke e zhvlerësuar edhe në këtë këndvështrim pretendimin e tij për garantimin e parimit të sigurisë juridike.

**10.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi i Komisionit ka qenë i paragjykuar, pasi në konkluzionet e ILDKPKI-së ai ka rezultuar me burime të ligjshme të pasurisë për të justifikuar pasuritë e vëna prej tij, trupi gjykues analizoi aktet e ndodhura në fashikujt e përcjellë nga Komisioni. Nga përmbajtja e tyre rezulton se Komisioni në vendimin e tij nuk është bazuar vetëm në të dhënat dhe provat e paraqitura në raportin e ILDKPKI-së, por edhe në aktet e provat e administruara gjatë hetimit, përgjigjet e subjektit në pyetësorë, parashtrimet e subjektit të rivlerësimit pas përfundimit të hetimit administrativ, si dhe në provat e depozituara në funksion të përmbysjes së barrës së provës. Në lidhje me aktet e marra në konsideratë nga Komisioni në funksion të vendimmarrjes, vendimi është bazuar në një sërë dokumentesh të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit ndër vite, akte të administruara në funksion të hetimit administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, shpjegimet me shkrim të përcjella nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit etj.

**10.1.** Trupi gjykues çmon të theksojë se procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i cili kryhet nga Komisioni, në bazë dhe për zbatim të parashikimeve të nenit

<sup>10</sup> Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 18/2003 dhe nr. 35/2007.

<sup>11</sup> Shih: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2015\)045-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2015)045-e), paragrafi 8  
Faqja 9 nga 30

179/b të Kushtetutës, neneve të Aneksit të saj dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, ndonëse e ka pikënisjen nga raportet e përpiluara nga organet ndihmëse të përcaktuara me ligj (ILDKPKI, DSIK dhe Inspektorati i KLD-së/KLGj/KLP), për të bërë vlerësimin e secilit prej tri kriterëve të rivlerësimit, i nënshtrohet një procesi të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi nga Komisioni, i cili, referuar edhe qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese në vendimin e saj nr. 2/2017, nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet ndihmëse, si sipërcituar. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit nuk qëndron.

11. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se arsyetimi i Komisionit, në vendimin objekt shqyrtimi, vjen në kundërshtim me praktikën e Komisionit dhe të Kolegjit në raste të ngjashme, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e Kolegjit në vendimmarrje<sup>12</sup> të mëparshme të tij, sipas së cilit: *“Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, sipas shkaqeve konkrete të ankimit, të cilat lidhen me vlerësimin e kriterëve të rivlerësimit, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe zbatimit të duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni”*. Trupi gjykues vëren se në pamundësi për të analizuar qëndrimin e Komisionit në rastet e cituara nga subjekti i rivlerësimit, pasi nuk disponon dokumentacionin përkatës të tyre, garanton se në kushtet kur çështja objekt gjykimi, që i përket subjektit të rivlerësimit Petref Asllani, do t’i nënshtrohet shqyrtimit në Kolegji, shkaqet ankimore të ngritura do të analizohen në koherencë me jurisprudencën e Kolegjit, vlerësuar nën dritën e rrethanave konkrete dhe provave të administruara për çështjen.
12. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk gjendet në kushtet e deklaramit të më shumë se dyfishit të pasurisë së ligjshme, parashikuar nga pika 1 e kësaj dispozite. Sipas subjektit të rivlerësimit, ndaj tij duhej të zbatohet parimi i proporcionalitetit lidhur me mënyrën e deklaramit në deklaratat periodike vjetore dhe jo të aplikohet masa ekstreme e shkarkimit nga detyra.

**12.1.** Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vëren se vendimi për shkarkimin e subjektit është marrë pasi është konstatuar se ai nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij dhe personave të lidhur, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe, si rrjedhojë, është në kushtet e parashikuara në pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, lexuar së bashku me nenin 33 të këtij ligji, për deklaramit të pamjaftueshëm të pasurisë. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit është gjetur në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për disa pasuri, ka kryer deklaramit të rremë dhe të pasaktë, pra, masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit ka ardhur në zbatim të përcaktimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për deklaramit të pamjaftueshëm. Vërtet subjekti nuk gjendet në kushtet e deklaramit të dyfishit të pasurisë së ligjshme, por asnjë prej paragrafëve përbërës së kësaj dispozite nuk sugjeron se ato përbëjnë kriterë të cilat duhet të përmbushen në mënyrë kumulative. Përkundrazi, situatat ligjore të cilat pasjellin shkarkimin nga detyra, sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, janë situata ligjore autonome, në këtë kuptim mjafton të gjendet e plotësuar një prej kushteve të parashikuara në njërin prej pikave për të pasjellë dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për sa më lart, ky pretendim është i pabazuar në ligj. Ndërsa pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi mënyrën e deklaramit dhe klasifikimit të tyre

---

<sup>12</sup> Shih vendimet e Kolegjit nr.1/2024 (JR), nr.33/2022(JR) dhe nr.35/2022 (JR).

në pasaktësi apo të kryera pa qëllim, fshehjen apo deklarin e rremë, trupi gjykues sqaron se ato do të analizohen më poshtë në këtë vendim së bashku me shkaqet e ankimit me natyrë materiale që lidhen me analizimin e problematikave të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

13. Në përfundim, trupi gjykues, pasi kontrollon zhvillimin e procesit të rivlerësimit të subjektit nga Komisioni, si dhe analizoi dokumentacionin e fashikujve të administruar gjatë hetimit në Komision, konstatoi se: Nuk rezulton asnjë qëndrim paragjykes i mbajtur nga Komisioni dhe as ndonjë pretendim i ngritur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në këtë drejtim. Procesi i rivlerësimit është kryer sipas parashikimeve të akteve ligjore e rregullatore. Procedura e ndjekur nga ana e Komisionit në trajtimin e kërkesave të subjektit për marrjen e provave rezulton të jetë kryer në përputhje me parashikimet e nenit 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, nuk u konstatuan shkelje të natyrës procedurale, të cilat mund të përbënin cenim të së drejtës së subjektit për proces të rregullt ligjor.

### **C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë**

14. **Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip 77,8 m<sup>2</sup>, lagjja ”{\*\*\*}”, ap. {\*\*\*}, Elbasan, blerë më datë 25.09.2012 në vlerën 3.821.536 lekë**

#### **Në lidhje me çmimin e apartamentit dhe mënyrën e likuidimit**

14.1. Komisioni çmoi të konsiderojë si çmim blerjeje të pasurisë vlerën prej 50.000 eurosh, duke iu referuar deklaratës noteriale të datës 04.06.2012, ndërsa deklarimet e subjektit, se brenda këtij çmimi vëllai i tij do të blinte një pasuri tjetër, u konsideruan prej Komisionit si përpjekje e dështuar e tij për të kundërshtuar këtë çmim për të cilin ka qenë në pamundësi financiare për ta paguar. Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar një çmim fiktiv në kontratën e shitjes të datës 25.09.2012 prej 3.821.526 lekësh, si dhe ka kryer deklarin të rremë të çmimit në deklaratën *vetting*. Për këto arsye, në analizën financiare të subjektit si çmim i paguar për apartamentin në vitin 2012 është konsideruar vlera prej 50.000 eurosh.

14.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë konkluzion të Komisionit, duke kërkuar nga Kolegji që të përfshijë në analizë vlerën e përcaktuar në kontratën e shitjes të datës 25.09.2012 shumë prej 3.821.526 lekësh dhe jo atë referuar deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.06.2012, në vlerën prej 50.000 eurosh. Subjekti pretendon se nëse do të kishte për qëllim të fshihte vlerën e apartamentit dhe të deklaronte një çmim fiktiv blerjeje nuk do ta kishte paraqitur dhe dorëzuar deklaratën noteriale në përgjigje të pyetësorit nr. 1.

14.2/a. Në lidhje me vlerën 50.000 euro, të përmendur në deklaratën e datës 04.06.2012, të cilës i referohet Komisioni, subjekti pretendon se kjo shumë nuk i përket vetëm blerjes së apartamentit nr. {\*\*\*}, por lidhet edhe me heqjen nga bllokimi që banka i kishte bërë një apartamenti tjetër me nr. {\*\*\*}, që pretendonte të blinte vëllait i tij. Sipas subjektit, vlera e blerjes së apartamentit është negociuar me shitësin E. K. që në vitin 2010 dhe vlera 3.821.526 lekë ka qenë vlera e tregut, e çmimi i këtij apartamenti nuk mund të jetë në vitin 2010 në shumë 50.000 euro. Si përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkon që të përfshihet në analizën financiare çmimi i blerjes, sipas kontratës së shitblerjes nënshkruar midis palëve, në shumë 3.821.526 lekë.

**14.3.** Trupi gjykues vlerëson se në këto kushte çështja që shtrohet për diskutim është se cilin çmim do të konsiderojë në kontrollin e analizës financiare për blerjen e apartamentit ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, atij referuar prej Komisionit në vlerën prej 50.000 eurosh, sipas përcaktimeve të deklaratës noteriale të datës 04.06.2012, apo çmimit sipas kontratës së shitblerjes të datës 25.09.2012, të pretenduar prej subjektit të rivlerësimit.

**14.4.** Për këtë qëllim, u morën në shqyrtim nga trupi gjykues dhe u vlerësuan rrethanat në të cilat është përcaktuar çmimi i kësaj pasurie dhe qëllimi i deklaruar prej palëve në aktet noteriale. Në këtë kuadër u analizua sjellja e palëve në raport me këto akte, para dhe pas përpilimit të tyre, si dhe ndërveprimi i subjektit të rivlerësimit me palë të treta gjatë kësaj periudhe kohore, për çështje të lidhura me pasurinë objekt shqyrtimi. Nga analizimi i akteve të ndodhura në fashikullin e Komisionit trupi gjykues konstaton se:

**14.4/a.** Me kontratë shitblerje nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 25.09.2012, Petref Asllani ka blerë nga shtetasi E. K. apartament me sipërfaqe 77,8 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie {\*\*\*}, ndodhur në adresën lagjia “{\*\*\*}”, Elbasan, në vlerën 3.821.526 lekë, vlerë e likuiduar jashtë zyrës noteriale përpara hartimit të kontratës.

**14.4/b.** Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në lidhje me vlerën 50.000 euro të përmendur në deklaratën e datës 04.06.2012, ka sqaruar se kjo shumë nuk i përket vetëm blerjes së apartamentit të tij nr. {\*\*\*}, por edhe blerjes së një apartamenti tjetër, me nr. {\*\*\*} nga vëllai i tij P. A.. Subjekti, në mbështetje të pretendimeve të tij, ka paraqitur në Komision deklaratat noteriale si më poshtë.

i) Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.06.2012, të mbajtur midis shitësit të apartamentit E. K. dhe subjektit të rivlerësimit Petref Asllani mbi mënyrën e likuidimit të çmimit të apartamentit.

ii) Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.09.2012, e shtetasve E. K. (nëna e shitësit) dhe Petref Asllani, në të cilën deklarohet njohja e detyrimit prej 15.000 eurosh e shtetasit Petref Asllani, me qëllim realizimin përfundimtar të kontratës së shitjes së pasurisë apartament nr. {\*\*\*}, me sip. 77,8 m<sup>2</sup>.

iii) Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.03.2022, të shtetasve S. A. dhe P. A. (vëllezërit e subjektit të rivlerësimit), sipas së cilës S. A. deklaroi se i ka dhënë në dorë në qershor 2012 vëllait P. A. shumën prej 15.000 eurosh, me kushtin që t’ia kthente në fund të vitit 2012, ndërsa P.A. deklaroi të njëjtin fakt duke konfirmuar se ia ka kthyer atë në ndërrimin e viteve 2012/2013.

iv) Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.03.2022, në të cilën shtetasi P. A. deklaroi se më datë 04.06.2022 i ka dhënë në dorë vëllait Petref Asllani shumën prej 250.000 lekësh, pasi ia kërkoi për blerjen e apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, apartament i cili ndodhej në të njëjtin pallat ku donte të blinte dhe ai, dhe se kjo shumë është nga kursimet e tij.

v) Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.11.2012, sjellë bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit të dytë: E. K. (shitësi) së bashku me P. A., vëllai i subjektit, deklaroi se për shumën 90.000 lekë, që i detyrohej E. K. – P. A. do t’i likuidohet deri në 30.11.2012.

**14.5.** Trupi gjykues vlerësoi të ndalet fillimisht në analizimin e përcaktimeve dhe deklarimeve të palëve në deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.06.2012, mbajtur midis shitësit të apartamentit E. K. dhe subjektit të rivlerësimit Petref Asllani. Kjo deklaratë noteriale është nënshkruar vetëm nga subjekti dhe shitësi i pasurisë E. K., ndërsa vëllai i subjektit nuk

është deklarues në këtë deklaratë, palët kanë specifikuar apartamentin nr. {\*\*\*} që i përket subjektit dhe në asnjë moment nuk është përfshirë emri i vëllait të subjektit P. A. dhe as apartamenti nr. {\*\*\*} i pretenduar se do të blihej prej tij. Sipas kësaj deklarate, rezulton se për apartamentin nr. {\*\*\*}, deri në këtë datë, janë paguar 35.000 euro dhe se mbeten për t'u paguar dhe 15.000 euro, shumë e cila është parashikuar të likuidohet menjëherë me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes përfundimtare. Pra, në total, çmimi i shitjes së kësaj pasurie duket të jetë 50.000 euro. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit se çmimi prej 50.000 eurosh nuk i përket çmimit të shitjes vetëm të apartamentit të tij nr. {\*\*\*}, por dhe një apartamenti tjetër me nr. {\*\*\*}, që donte ta blinte vëllai i tij P. A., mbeten në nivel deklarativ dhe të pavërtetuara me akte shkresore.

**14.6.** Gjithashtu, trupi gjykues i konsideron të pabazuara pretendimet<sup>13</sup> e subjektit të rivlerësimit lidhur me shpjegimet e dhëna për përmbajtjen e deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.09.2012, të deklaruesve E. K. (nëna e shitësit) dhe Petref Asllani, në të cilën deklarohet njohja e detyrimit prej 15.000 eurosh e shtetasit Petref Asllani, me qëllim realizimin përfundimtar të kontratës së shitjes së pasurisë apartament nr. {\*\*\*}, me sip. 77,8 m<sup>2</sup>. Nga analizimi i kësaj deklarate, trupi gjykues konstaton se në deklaratën noteriale të datës 22.09.2012 nuk përmendet në asnjë moment/rast emri i vëllait të subjektit dhe as apartamenti nr. {\*\*\*} i pretenduar se do të blihej prej tij, por përcaktohet shprehimisht vetëm nr. {\*\*\*} i apartamentit të subjektit, numri i pasurisë dhe sipërfaqja e apartamentit të blerë prej tij. Kjo deklaratë nuk konfirmon se vlerat e paguara më parë lidhen edhe me apartamentin tjetër nr. {\*\*\*}, siç shpjegon subjekti se do të blihej nga vëllai i tij, por dhe nëse do të ishte kështu, në datën 22.09.2012, kur është hartuar deklarata, apartamenti tjetër nr. {\*\*\*}, që do blinte vëllai i tij, nuk ishte liruar nga banka dhe nuk ishte hequr ende sekuestro, pra, nuk ishte e mundur të kryhej shitja e apartamentit të vëllait<sup>14</sup> përpara hartimit të kësaj deklarate. Ky fakt vërtetohet referuar akteve<sup>15</sup> sipas së cilave rezulton se deklarata e lirimit nga banka dhe urdhri i heqjes së sekuestros nga ZVRPP-ja datë 13.09.2012 dhe datë 14.09.2012, për apartamentin nr. {\*\*\*}, datojnë më parë në kohë se hartimi i deklaratës noteriale të datës 22.09.2012.

**14.7.** Lidhur me deklaratën noteriale të datës 19.11.2012, mbajtur midis shitësve e P. A. (vëllait të subjektit), trupi gjykues konstaton se ajo ka lidhje me marrëdhënien e vëllait të tij me E. K. e nuk ndërlihet me marrëdhënien e shitësve me subjektin e rivlerësimit. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, ashtu si dhe në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision, përpiqet që të përfshijë dhe marrëdhënien e vëllait e dëshirën e tij për të blerë apartament, në të njëjtin shitës, por që siç shpjegon edhe vetë nuk u konkludua me blerje. Kjo mënyrë e të paraqiturit të fakteve prej subjektit të rivlerësimit duket se kryhet për t'i ndërthurur

<sup>13</sup> Sipas subjektit të rivlerësimit shuma prej 15.000 eurosh i është dhënë shtetasit E. K. fillimisht nëpërmjet transfertës bankare më datë 27.06.2012, bashkë me vëllain P. A., në nr. e llogarisë {\*\*\*} përfituesit Head Office-Tirana, ku shitësi E. K. kishte lënë si garanci hipotekore apartamentin që kishte blerë, ndërsa diferenca i është dhënë në lekë në momentin e kalimit të pronësisë më datë 25.09.2012. Subjekti pretendon se akti bankar i datës 27.06.2012 për depozitim të shumës prej 15.000 eurosh në Raiffeisen Bank për përfituesin Head Office, me përshkrim "Petref Asllani dhe P. A. derdh për llog të dep ligjor", tregon qartësisht se kjo pagesë nuk po kryhet vetëm për apartamentin me nr. pasurie {\*\*\*}, që ai kërkonte të blinte, por dhe për një pasuri tjetër që duhej të çlirohej pasi mbahej e bllokuar nga banka.

<sup>14</sup> Subjekti në pyetësorin nr. 2, paragraf 1.3 ka shpjeguar se vlerat e paguara iu kthyen nga shitësi vëllait.

<sup>15</sup> Sipas aktit "Urdhër" nr. {\*\*\*}, datë 14.09.2012, sjellë nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, urdhërohet heqje e masës sekuestro nga banka për pasurinë me nr. {\*\*\*}, në lagjen "{\*\*\*}", Elbasan, si dhe deklarata noteriale e Raiffeisen Bank, datë 13.09.2012, për lirimin e kolateralit për apartamentin nr. {\*\*\*}, në lagjen "{\*\*\*}", Elbasan.

më pas këto situata me qëllimin që të krijojë konfuzion me pagesat e kryera, kohën e tyre dhe për të mbështetur pretendimin e tij se apartamenti është blerë me çmimin e kontratës së shitjes [3.821.536 lekë] dhe jo me çmimin [pagesat apo detyrimet] që pohohen prej tij në deklaratat noteriale me shitësit datë 04.06.2012 dhe 22.09.2012 [për total çmimin e shitjes prej 50.000 eurosh]. Lidhur me deklaratat noteriale të vëllezërve të tij S. dhe P. A., të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se ato, jo vetëm që kanë një vlerë të kufizuar provuese, por nuk janë në përputhje me deklaratat e kohës kur janë kryer veprimet lidhur me këtë pasuri, duke krijuar kundërtënie që krijojnë vështirësi në procesin e rivlerësimit.

**14.8.** Trupi gjykues evidentoi disa fakte me rëndësi në kontekstin e analizës së fiktivitetit të veprimeve të subjektit, lidhur me çmimin e vendosur në kontratë, si: (i) deklaratat noteriale midis subjektit dhe shitësit që kanë rregulluar marrëdhënien e detyrime/pagesave për këtë pasuri, janë akte të firmosura më përpara në kohë [04.06.2012 dhe 22.09.2012] se sa firmosja e kontratës së shitjes [25.09.2012]; (ii) deklarata noteriale e datës 22.09.2012 është hartuar dhe nënshkruar me qëllim që pala shitëse të sigurohej për pagimin e shumës 15.000 euro nga subjekti i rivlerësimit, për të plotësuar çmimin 50.000 euro të dakordësuar sipas deklaratës më datë 04.06.2012; (iii) vetëm tri ditë pas hartimit të deklaratës noteriale në datën 25.09.2012 është lidhur me akt noterial kontrata përfundimtare e shitjes për këtë pasuri me nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 25.09.2012, ku çmimi i shitjes është vënë pikërisht sipas vlerave të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave dhe duket të jetë vënë minimalisht me qëllim evitimin e pagimit të tatimit mbi të ardhurën reale nga shitja; (iv) vënia e çmimit prej 50.000 eurosh do ta vinte subjektin në pozita më të disfavorshme sesa për të justifikuar pagimin vetëm të vlerës 3.821.526 lekë (pasi, sikurse rezulton, subjekti nuk justifikon me të ardhura të ligjshme shumën 50.000 euro).

**14.9.** Nga sa më lart, trupi gjykues vlerëson se megjithëse kontrata e shitjes edhe deklaratat janë akte të nënshkruara para noterit, vlera provuese e tyre dhe besueshmëria që ato paraqesin në këtë proces u analizuan në përputhje me faktet e tjera dhe rrethanat në të cilat janë kryer veprimet juridike të palëve, për të mundësuar evidentimin e plotë të qëllimit, synimit dhe pasojave që ato kanë kërkuar të arrijnë nëpërmjet nënshkrimit të këtyre akteve. Në përfundim të analizës së rrethanave të mësipërme, me provat e sipërpërmendura, trupi gjykues konstaton se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë kontradiktore lidhur me çmimin e blerjes së pasurisë objekt vlerësimi dhe likuidimin e tij, shpjegimet e tij për rrethanat faktike në të cilat kanë ndodhur veprimet juridike, mbetën deklarative e jobindëse, çmimi i shënuar në kontratën e shitjes nuk është çmimi real. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të bazuar konkluzionin e Komisionit se çmimi i blerjes së kësaj pasurie është në vlerën prej 50.000 eurosh, sipas deklaratës noteriale të datës 04.06.2012.

- 15.** Në funksion të verifikimit të mundësisë së subjektit për të financuar me burime të ligjshme blerjen e apartamentit të ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, trupi gjykues konstaton se në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dy burime krijimi për këtë pasuri, konkretisht: (a) shumën prej 3.345.117 lekësh, të përfituar nga shitja e apartamentit me nr. pasurie {\*\*\*}, lagjia “{\*\*\*}”, Elbasan; dhe (b) shumën prej 476.719 lekësh, të ardhura nga paga. Në këto kushte, trupi gjykues mori fillimisht në analizë burimin e parë dhe kryesor të deklaruar prej subjektit të rivlerësimit, pasurinë apartament, në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan.

**15.1.** Komisioni vlerësoi të mos i konsiderojë të ardhurat nga shitja e apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, si burim i ligjshëm për krijimin e apartamentit nr. {\*\*\*}, të ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, blerë më datë 25.09.2012. Sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e pasurisë për shkak të balancës negative në shumën (-) 6.685.737 lekë. Subjekti ka kryer veprime fiktive, deklarime të rreme e të pamjaftueshme si për pasurinë objekt vlerësimi të deklaruar në deklaratën *vetting*, apartament në lagjen “{\*\*\*}”, ashtu edhe për apartamentin që të ardhurat nga shitja e të cilit janë deklaruar si burim për blerjen e tij, duke qenë në kushtet e nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

**15.2.** Subjekti i rivlerësimit, në ankim, duke kundërshtuar konkluzionet e mësipërme të Komisionit si të pabazuara dhe të gabuara, ka sqaruar rrethanat se si ka përfitur shumën prej 3.345.117 lekësh, megjithëse nuk ishte palë në kontratën e shitblerjes së apartamentit midis shitësit Q. H. dhe blerësit B. R. dhe arsyet se përse të ardhurat nga shitja e apartamentit të mësipërm nga Q. H. (shitësi) i janë dhënë atij, konkretisht.

**15.2/a.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk kishte për qëllim të shiste apartamentin e ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, në muajin janar të vitit 2001 Entit Kombëtar të Banesave (në vijim “EKB”), pasi kishte vetëm pak muaj që e kishte blerë, por e ka kryer këtë shitje për t’i ardhur në ndihmë familjes H., e cila kishte fituar statusin si i pastrehë. Shumën prej 2.258.000 lekësh, të përfitur nga shitja e apartamentit EKB-së, subjekti pretendon se nuk e ka përdorur, por ia ka dhënë dorazi shtetasit Q. H.. Subjekti pretendon se gjatë gjithë procesit penal, por edhe në procesin administrativ të kryer në Komision, Q. H. ka konfirmuar se e ka marrë dorazi shumën prej 2.258.000 lekësh që përfaqësonte çmimin e shitjes së apartamentit të tij. Për të blerë apartamentin, familja H. kishte lidhur kontratën e shitjes me këste nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.09.2001, me EKB-në Elbasan, si dhe kishte lënë po të njëjtin apartament si kolateral për të kthyer kredinë e akorduar<sup>16</sup>. Në vitin 2010, familja H. këtë apartament ia ka shitur në shumën 3.345.117 lekë drejtpërdrejt shtetasit B. R.. Lidhur me këtë fakt, subjekti ka sqaruar se ky veprim juridik është kryer me qëllimin për të mos hartuar dy kontrata shitblerjeje nga familja H. te subjekti dhe më pas nga subjekti te B. R.. Sipas subjektit, shuma prej 3.345.117 lekësh është përfitur prej tij në vitin 2012 dhe është përdorur si burim krijimi<sup>17</sup> për apartamentin nr. {\*\*\*}, ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan. Subjekti në këtë dokument sqaron se lidhur me këtë pasuri ka dhënë shpjegime përpara inspektorit të verifikimit të pasurive në ILDKPKI në shkurt të vitit 2015. Subjekti i rivlerësimit sqaron se bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting* ka paraqitur një relacion shpjegues dhe të detajuar për këtë pasuri.

**15.2/b.** Subjekti i rivlerësimit sqaron se në kohën kur janë kryer këto transaksione nuk kanë qenë subjekte deklaruese (ai dhe Q. H.) dhe këto veprime i ka kryer në mirëbesim me familjen H.. Subjekti konfirmon se me shtetasin Q. H. nuk kishte nënshkruar kontratë për dhënien e huasë dhe në momentin e deklarimit në vitin 2003 nuk e kishte të formalizuar marrëdhënien e huasë.

---

<sup>16</sup> Subjekti sqaron se prej familjes H. kishte marrë garanci verbale se në një periudhë të shkurtër kohe do të huazonte fonde nga të afërm dhe do të mbyllte kredinë e marrë për blerjen e apartamentit, e më pas familja H. do të shiste apartamentin për të njëjtin vlerë që ai i kishte shitur EKB-së. Sipas subjektit, formalizimi i akteve për marrjen e kredisë nga familja H. si e pastrehë dhe kryerja e veprimeve juridike me atë apartament me atë procedurë na janë sugjeruar dhe zbatuar nga punonjës të EKB-së.

<sup>17</sup> Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, është shprehur se shtetasi B. R. në vitin 2010 i dha si garanci shtetasit P. K. shumën 2.500 euro, për të garantuar blerjen e apartamentit nr. {\*\*\*} nga unë, duke më lënë të vazhdoja të banoja në po këtë apartament dhe më ka shlyer pjesën tjetër prej 3.000.000 lekësh në vitin 2012.

15.2/c. Sipas subjektit të rivlerësimit, nëse do të merren në konsideratë pretendimet e mësipërme të tij, ai do të rezultojë me një balancë negative prej (-) 152.360 lekësh për vitin 2014, balancë kjo që në parimin e proporcionalitetit nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore.

15.3. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit e mbështet ankimin e tij në interpretime të fakteve dhe rrethanave të ndodhura në atë periudhë, sipas variantit të paraqitur prej tij edhe në shpjegimet e dhëna në Komision, lidhur me origjinën e apartamentit të ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, që ka shërbyer si burim krijimi, si dhe mënyrën e përfitimit të shumave nga transaksionet e kryera mbi këto pasuri.

15.4. Me qëllim qartësimin e situatës së marrëdhënies së subjektit të rivlerësimit me shtetasin Q. H. (ish-gjyqtar) dhe verifikimin e lidhjes së tyre me apartamentin me nr. pasurie {\*\*\*}, ap. nr. {\*\*\*}, pall. {\*\*\*}, të ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, trupi gjykues mori në shqyrtim të gjitha faktet që rezultojnë nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, duke i ballafaquar me pretendimet e subjektit dhe konkluzionet e Komisionit nga të cilat konstatohet sa vijon:

15.4/a. Me kontratë shitje me këste, me kusht, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.09.2001, shtetasi Q. H. ka blerë nga EKB-ja Elbasan banesën nr. {\*\*\*} e ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, me vlerën prej 1.688.320 lekësh, pas uljeve të aplikuara sipas ligjeve në fuqi, pasi kishte statusin si i pastrehë<sup>18</sup>.

15.4/b. Kontratë shitje apartament banimi me pagesë të menjëhershme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.07.2010, sipas së cilës EKB-ja i ka shitur shtetasit Q. H. pasurinë me nr. {\*\*\*}, ap. nr. {\*\*\*}, pall. {\*\*\*}, në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, me sip. 68,29 m<sup>2</sup>, me vlerën 2.348.320 lekë<sup>19</sup>, por nga statusi i pastrehë që kishte i janë akorduar zbritje e nga detyrimi 1.688.320 lekë ishin paguar 652.790 lekë. Gjithashtu, Q. H. ka përfituar zbritje tjetër prej 30% për pagesë të menjëhershme prej 310.661 lekësh, u pagua edhe diferenca prej 724.900 lekësh për të kaluar pronësinë (pra, në total, është paguar nga Q. H. vlera prej 1.377.690 lekësh<sup>20</sup>, më pak prej 880.310 lekësh nga çmimi që EKB-ja ia bleu Petref Asllanit).

15.4/c. Me kontratë shitblerje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 30.07.2010, pra, vetëm dy ditë më vonë, shtetasi Q. H. dhe familjarët e tij, i shesin shtetasit B. R. apartament me sip. 68,29 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit prej 3.345.117 lekësh<sup>21</sup> (ose më shumë nga çfarë i pagoi EKB-së prej 1.967.427 lekësh), likuiduar jashtë zyrës noteriale. Sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor i datës 12.08.2010, apartamenti nr. {\*\*\*}, me sip. 68,29 m<sup>2</sup> figuron në pronësi të shtetasit B. R..

---

<sup>18</sup> Vendim nr. {\*\*\*}, datë 30.11.2000, Bashkia Librazhd, ku Q. H. të trajtohet me strehim si i pastrehë. Shkresë e Këshillit Ministrave nr. {\*\*\*} prot., datë 11.05.2001, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave, ku shprehet se Q. H. të procedohet me trajtimin për strehim nga dega e Entit Kombëtar të Banesave, Elbasan.

<sup>19</sup> Sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor, datë 30.7.2010, pasuria apartament në pallatin nr. {\*\*\*}, me nr. pasurie {\*\*\*}, me sip. 68,29 m<sup>2</sup> figuron në pronësi të Q. H. dhe familjarëve të tij.

<sup>20</sup> Si total i vlerës paguar prej 652.790 lekësh dhe pagesës menjëhershme prej 724.900 lekësh.

<sup>21</sup> Me çmimin për metër katror sipas EKB-së, referuar Udhëzimit Nr. 3, datë 03.02.2010, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010”, prej 48.984 lekë /m<sup>2</sup> ose 48.984 lekë /m<sup>2</sup> x 68,29 m<sup>2</sup> = 3.345.117 lekë.

**15.4ç.** Lidhur me përfitimin e shumës nga shitja e pasurisë, referuar kontratave të mësipërme, subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit të dytë datë 08.03.2023, ka shpjeguar<sup>22</sup> se: *“Deklarimet janë në dukje kontradiktore, por në fakt nuk është i tillë. Them në dukje, pasi nga shitja e apartamentit në vitin 2001 në vlerën 2.258.000 lekë, kjo vlerë, tashmë pasuri e imja iu dha Entit Kombëtar Banesave si garanci për shlyerjen e kredisë nga familja H.. Në Deklaratën Origjinale (ndodhur në ILDKPKI) e Personit që Mbart Detyrime për Deklarim Pasurie, formulari A-5, te burimi, janë edhe kursimet e subjektit, pra, nuk ka mospërputhje, por domosdoshmërisht përfshihen edhe kursimet e mia dhe familjes sime. Deri në vitin 2010 vlera e apartamentit të vendosur si garanci është rritur dhe, pikërisht, në vitin 2010 ky apartament në treg të lirë, pati vlerën 3.345.117 lekë, vlerë e cila u mor nga unë cash nga shtetasi B. R. dhe shërbeu si burim për krijimin e pasurisë, apartamentit nr. {\*\*\*} në pallatin {\*\*\*}”.*

Trupi gjykues mori në shqyrtim konkluzionet e Komisionit, në funksion të analizimit të pretendimeve të subjektit të paraqitura në ankim, duke ia nënshtuar kontrollit çështjet që kanë të bëjnë me mënyrën e përfitimit të shumës nga shitja e apartamentit të ndodhur lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, si dhe sjelljen e subjektit me këtë pasuri, dhe vlerëson si vijon.

**15.5.** Trupi gjykues fillimisht konstaton se, ashtu sikurse e pranon edhe vetë subjekti i rivlerësimit, të gjitha veprimet e tij me z. Q. H. (dhënia dhe marrja e shumave të konsiderueshme) janë kryer pa asnjë dokumentacion provues, duke mbetur një marrëdhënie, e cila do të duhet të vlerësohet vetëm mbi besueshmërinë e thënieve të subjektit apo deklaratave noteriale të hartuara shumë kohë më vonë se janë kryer veprimet juridike dhe madje në funksion të një procedimi penal në ngarkim të këtyre subjekteve, elemente që përcaktojnë nevojën e tyre për t’u mbrojtur dhe dobësojnë vlerën provuese të deklaratave, sepse largohen nga vullneti i çlirët i deklaruesve.

**15.6.** Lidhur me të ardhurat e përfituara nga kontrata e shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 30.07.2010, e deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting* si burim krijimi i pasurisë në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, trupi gjykues konstaton se kjo kontratë nuk rezulton të jetë lidhur nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose bashkëshortja e tij në cilësinë e palës shitëse, por, është e lidhur mes shtetasve Q. H. (shitës) dhe B. R. (blerës). Për rrjedhojë, mbeti e paprovuar me dokumentacion ligjor se të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie janë përfituar prej tij pas dy vitesh, në vitin 2012, pasi nuk ka asnjë provë shkresore që të vërtetojë të ardhura të përfituara prej tij nga shitja e kësaj pasurie si në vitin 2010, ashtu dhe në vitin 2012.

**15.7.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, në ankim, se për *saktësimin e kësaj situatë faktike dhe juridike kam dhënë shpjegime përpara inspektorit të ILDKPKI-së që në vitin 2004 dhe e kam deklaruar saktësisht edhe me deklaratën noteriale në vitin 2011*, trupi gjykues konstaton se subjekti referon sqarime në ILDKPKI në vitin 2004, por në fashikuj dhe në shkresën që ILDKPKI-ja i ka dërguar Komisionit akte, me nr. {\*\*\*} prot., datë 09.11.2021, ka bashkëlidhur vetëm procesverbalin e datës 03.02.2015, pra, nuk rezulton të ketë akte apo shpjegime të dhëna përpara inspektorit në vitin 2004. Gjithashtu, subjekti nuk i referon këto sqarime të dhëna të pretenduara përpara inspektorit të ILDKPKI-së në vitin 2004, as në

---

<sup>22</sup> Lidhur me pyetjen e Komisionit *“Jepni sqarime mbi mospërputhjet e deklarimeve tuaja lidhur me shitjen e apartamentit në lagjen {\*\*\*}, me veprimet juridike të kryera, duke përcaktuar vitin e saktë të përfitimit të çmimit të shitjes”.*

relacionin shpjegues bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, por referon vetëm sqarimet e dhëna në procesverbalin e vitit 2015. Ndërsa i vetmi akt i kohës, në të cilin pasqyrohen veprimet juridike të kryera me apartamentin në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, pasqyrohen nga deklarimi i bërë para noterit nga vetë subjekti i rivlerësimit Petref Asllani, në deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 09.11.2011, në të cilën vetë subjekti deklaroi se apartamentin në lagjen “{\*\*\*}” ia ka shitur formalisht EKB-së në vitin 2001.

**15.8.** Nga kontrolli i deklaratave të interesave periodike, rezultoi se në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003 subjekti ka deklaruar: “*Gjendje në cash, 3 milion lekë, të ndodhura në banesë, me burim nga shitja e apartamentit*”. Trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit se me termin “*likuiditete*” në formular dekloroheshin si shuma e gjendjes *cash* ashtu dhe huadhëniet, nuk qëndron, pasi vetë ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, shpjegon se termi “*likuiditete*” përmban dhe *cash* dhe huadhënie, ashtu si dhe elemente të tjera<sup>23</sup>, por subjekti në mënyrë të qartë ka deklaruar “*gjendje në cash [...] ndodhura në banesë*”, pra, ka zgjedhur të specifikojë se likuiditeti i deklaruar ndodhet në banesë e nuk i është dhënë hua Q. H. Pavarësisht shpjegimeve apo elementeve/indicieve të deklaruara, qoftë në deklarata noteriale të subjektit në datën 09.11.2011 apo në procesverbalin me ILDKPKI-në në datën 03.02.2015, subjekti nuk e ka deklaruar as në vijim në DIPP-të e viteve 2004 – 2012 këtë marrëdhënie (huaje) në shumë të konsiderueshme me shtetasin Q. H. apo ndonjë transaksion të kryer me këtë familje, pra, nuk arrihet të provohet një nga pretendimet e subjektit se shumë të përfituar nga shitja e apartamentit në vitin 2001, ia ka dhënë z. Q. H. në formë huaje.

**15.9.** Përkundrazi, konstatohet se subjekti ia ka shitur EKB-së Elbasan apartamentin me nr. pasurie {\*\*\*}, në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, që në vitin 2001, me çmim 2.258.000 lekë, shumë e kaluar në rrugë bankare<sup>24</sup>, apartament i cili u regjistrua në pronësi të EKB-së. Ky detyrim i pashlyer mbetet i njëjtë pavarësisht konkluzioneve të vendimit penal, sipas së cilit këto veprime të subjektit nuk konsiderohen se formojnë elemente të veprës penale për të cilën ai është akuzuar. Edhe në DIPP-të e viteve 2010 dhe 2012 nuk rezultoi që subjekti të ketë deklaruar të ardhura nga shitja e kësaj pasurie, ndërkohë që këto të ardhura i ka deklaruar në DPFD-në e vitit 2003. Në jurisprudencën<sup>25</sup> e Kolegjit të mbajtur në raste të ngjashme, kontrolli i deklaratës *vetting* dhe krahasimi i saj me deklaratimet e interesave privatë periodikë/vjetorë i shërben Komisionit dhe Kolegjit për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, pra, mjaftueshmërinë e deklarimeve të tij.

**15.10.** Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore e të pabazuara në akte shkresore, pasi nga njëra anë në DIPP-në e vitit 2003 ka deklaruar se likuiditeti *cash* në banesë është me burim nga shitja e pasurisë dhe, nga ana tjetër, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, deklaroi se shumë prej 2.258.000 lekësh ia dha EKB-së si garanci për shlyerjen e kredisë nga familja H. e, më tej, shpjegoi se shuma e përfituar nga shitja i është dhënë hua shtetasit Q. H., me të cilën ky i fundit bleu një apartament në Tiranë, pa e mbështetur

<sup>23</sup> Neni 2, Përkufizime, pika 2, “*Likuiditete*” janë mjetet monetare, të vendosura në *cash*, llogari rrjedhëse, depozita, me dhe pa afat, bono thesari, obligacione dhe huadhënie.

<sup>24</sup> Nëpërmjet mandatpagesës së datës 02.08.2001, të Bankës së Kursimeve, sipas së cilës rezultoi se EKB-ja Elbasan ka paguar në favor të subjektit shumë prej 2.258.000 lekësh, me përshkrimin “*Blerje në tregun e lirë*”.

<sup>25</sup> Vendimet nr. 6/2018 (JR), nr. 7/2018 (JR), nr. 8/2018 (JR), nr. 9/2018 (JR), nr. 10/2018 (JR), nr. 12/2018 (JR), nr. 9/2019 (JR), nr. 19/2019 (JR) dhe nr. 19/2019 (JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

këtë fakt me ndonjë akt shkresor. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se shumë e përfituar nga shitja e apartamentit ia ka dhënë shtetasit Q. H. dorazi, por pa formalizuar marrëdhënien e huasë. Nga sa më lart, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se veprimet e kryera prej subjektit për këtë pasuri duken fiktive.

**15.11.** Trupi gjykues mori në analizë edhe deklaratën<sup>26</sup> noteriale nr. {\*\*\*}, datë 10.12.2014, të shtetasit B. R. (blerësi i apartamentit), i cili, ndër të tjera, ka deklaruar se: *Në vitin 2010 ka blerë nga shtetasi Q. H. apartamentin 2+1 me sip. 68,29 m<sup>2</sup> në lagjen “{\*\*\*}” Elbasan, apartament në të cilin faktikisht jetonte shtetasi Petref Asllani, i cili banoi në këtë apartament deri sa u sistemua në apartamentin e ri (pasuria apartament deklaruar në deklaratën vetting). Më tej, ai ka deklaruar se ka hyrë për të banuar në këtë apartament në vitin 2012, kohë kur ka bërë dhe likuidimin për blerjen e tij. Sikurse konstatohet qartazi, shtetasi B. R. në këtë deklaratë nuk pohon faktin që shumë e paguar për blerjen e këtij apartamenti ia ka dhënë subjektit, por vetëm tregon faktin se në këtë apartament banonte shtetasi Petref Asllani. Pra, në kuptim të provueshmërisë, ky akt noterial nuk pasqyron ndonjë të dhënë që do të mund të provonte apo konfirmonte pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me përfitimin në mënyrë të tërthortë të shumësi si të ardhur nga shitja e apartamentit.*

**15.12.** Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se shuma e përfituar nga shitja e pasurisë në vitin 2001 i është dhënë hua shtetasit Q. H. dhe të ardhurat nga shitja e pasurisë në vitin 2012 nuk i ka marrë shtetasi Q. H. por i ka marrë vetë subjekti, mbeten të pavërtetuara me akte shkresore. Madje ato bien në kundërshtim në jo pak raste me vetë deklaratimet e subjektit apo dokumentet e administruara gjatë procesit administrativ në Komision. Ky konkluzion bazohet në situatën faktike të konstatuar si vijon:

i) Në deklarin periodik të vitit 2012, kur është blerë pasuria, nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar të ardhura nga shitja e apartamentit në lagjen “{\*\*\*}” dhe as pakësim të likuiditeteve *cash*, si dhe nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë;

ii) Subjekti e ka humbur pronësinë e apartamentit në lagjen “{\*\*\*}” që në vitin 2001 (edhe pse ka jetuar në këtë apartament pa ndërprerje deri në 2012) kur është vërtetuar që ka përfituar në rrugë bankare nga EKB-ja çmimin e shitjes së pasurisë dhe të cilën e ka deklaruar si gjendje likuiditeti në *cash* në banesë në DPFD 2003 dhe, për rrjedhojë, të ardhurat nga kontrata e shitjes së vitit 2010 me blerës B. R., ku subjekti nuk është palë në kontratë, nuk mund të pranohen se kanë shërbyer si burim;

iii) Nuk ka asnjë dokument ligjor provues, ku të konfirmohet se subjekti i rivlerësimit ka përfituar në vitin 2012 shumë 3.345.117 lekë nga shtetasi B. R., pasi edhe në deklaratën noteriale të lëshuar prej këtij të fundit në vitin 2014 nuk deklarohet e nuk pranohet që këtë shumë ia ka dhënë subjektit. Ky deklarin bie në kundërshtim me pretendimin e subjektit, në ankim, se një pjesë e të ardhurave nga shitja e pasurisë i janë marrë shtetasit B. R. në vitin 2010 dhe pjesa tjetër (pjesa më e madhe) janë marrë në vitin 2012.

**15.13.** Në një analizë tërësore të të gjitha provave të administruara në raport me deklaratimet e subjektit ndër vite dhe gjatë procesit të rivlerësimit, lidhur me rrethanat e fitimit dhe disponimit të pronësisë mbi këtë pasuri, burimet e krijimit të saj dhe mënyrën e përfitimit dhe pagimit të shumësi, konstatohet lehtësisht se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime kontradiktore, si dhe ka kryer veprime fiktive në lidhje me apartamentin e ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan.

<sup>26</sup> Kjo deklaratë është dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur relacionit në deklaratën e pasurisë vetting.

Për shkak të këtyre deklarimeve, rezulton e vështirë të merret një qëndrim rreth fakteve të ndodhura dhe kohës së tyre, duke vështirësuar punën e organeve të rivlerësimit për të bërë një vlerësim që i afrohet sa më shumë të vërtetës jetësore, lidhur me faktet juridike që kanë shoqëruar krijimin e kësaj pasurie. Pavarësisht kësaj paqartësie e kontradiktoriteti, trupi gjykues, në analizë të të dhënave që vijnë nga shpjegimet e subjektit si më lartpërkthuar, konstaton se deklaratimet e tij, të dhëna në deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie dhe mënyrën e përfitimit të shumës, nuk gjejnë mbështetje në deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike vjetore.

**15.14.** Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se me të drejtë Komisioni nuk i ka konsideruar si burim për blerjen e pasurisë apartament në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, të ardhurat prej 3.345.117 lekësh, përfituar nga shitja e pasurisë në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, sipas kontratës së shitjes më datë 30.7.2010, me palë shitëse Q. H. dhe palë blerëse B. R., deklaruar nga subjekti si burim në deklaratën e pasurisë *vetting*.

**15.15.** Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në *deklaratën vetting*, në lidhje me burimin e të ardhurave nga shitja e pasurisë e ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, me sip. 68,29 m<sup>2</sup>, pasi edhe në versionin e pretenduar prej subjektit, burimi i të ardhurave nuk është në vetvete shitja e apartamentit të shtetasi B. R., por e gjithë marrëdhënia e krijuar mes subjektit dhe Q. H., situatë kjo që e vendos atë në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.

**15.16.** Trupi gjykues, në vijim, mbështetur në qëndrimet e mësipërme, mori në shqyrtim pretendimet e subjektit lidhur me konkluzionin e Komisionit se subjekti ka burime të pamjaftueshme financiare për blerjen e apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, blerë në vitin 2012, ashtu edhe për apartamentin e ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan.

**15.17.** Trupi gjykues konstaton se për mundësinë e blerjes së apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, Komisioni ka kryer analizën e periudhës 01.01.2012-25.09.2012 dhe i ka rezultuar se subjekti nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme blerjen e apartamentit më datë 25.09.2012 në vlerën prej 50.000 eurosh ose ekuivalenti 6.979.500 lekë – çmimi sipas deklaratës noteriale të subjektit me shitësit në datën 04.06.2012, duke konkluduar në vendim<sup>27</sup> se subjekti i rivlerësimit ka një diferencë negative prej (-) 6.685.737 lekësh.

**15.18.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *Komisioni ka kryer një analizë fragmentare për periudhën 01.01.2012-.09.2012, duke aluduar sikur familja ime ka jetuar vetëm në këto muaj dhe nuk ka pasur asnjë lloj të ardhure të mëparshme*, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit: (i) *shitjen e apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, prej 3.345.117 lekësh*; dhe (ii) *476.719 lekë të ardhura nga paga*, pra, nuk rezulton të ketë deklaruar se është përdorur ndonjë burim tjetër si kursimet apo likuiditetet *cash* në vite, gjithashtu, edhe në DIPP-në e vitit 2012, subjekti nuk ka deklaruar pakësim të likuiditeteve *cash*, me qëllim që të provonte të ardhura të tjera që mund të kenë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë objekt vlerësimi. Në këtë mënyrë, trupi gjykues, duke konsideruar deklaramin e subjektit për burimin

---

<sup>27</sup> Parag. 40 [faqe 21] vendimi i Komisionit.

me të ardhura nga paga, vlerëson të drejtë analizën e pjeshme të kryer nga Komisioni për periudhën nga fillimi i vitit deri në datën e kontratës së blerjes [periudhën 01.01.2012 – 25.09.2012], për rrjedhojë pretendimi i subjektit nuk qëndron.

**15.19.** Trupi gjykues mori në analizë edhe pretendimin e subjektit, në ankim, se *Komisioni nuk përfshin në analizën financiare shumën prej 2.258.000 lekësh që ka ardhur nga shitja e apartamentit në lagjen “{\*\*\*}” dhe as gjendjen cash të deklaruar ndër vite në DPV-të e dorëzuara në ILDKPKI. Përpara Komisionit kam paraqitur një analizë financiare, e cila provon se nuk ka pamjaftueshmëri të ardhurash. Së pari, trupi gjykues konstaton se subjekti, nuk ka paraqitur një analizë financiare të tijën për periudhën 01.01.2012-25.09.2012, por duket se referon analizën totale të vitit 2012, në prapësimet e paraqitura në Komision, ku i ka rezultuar me diferencë pozitive prej (+) 595.581 lekësh<sup>28</sup> dhe së dyti, lidhur me të ardhurat nga shitja e apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan (trajtuar më sipër në këtë vendim), subjekti referon si të ardhur vlerën prej 2.258.000 lekësh, e cila nuk është vlere e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* nga shitja e apartamentit B. R., sipas kontratës nr. {\*\*\*}, datë 30.07.2010, prej 3.345.117 lekësh, por i përket vlerës që subjekti ia shiti këtë apartament EKB-së në datën 27.07.2001. Trupi gjykues konstaton se kjo e ardhur është konsideruar nga Komisioni në analizën deri më 31.12.2003, pasi është deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2003, si likuiditet *cash* në shumën prej 3.000.000 lekësh, si dhe së treti, lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni nuk ka konsideruar dhe gjendjen e likuiditetit *cash* të deklaruar prej tij ndër vite si burim krijimi, trupi gjykues vlerëson se në kushtet kur subjekti nuk e ka deklaruar *cash-in* si burim të krijimit të pasurisë në deklaratën e pasurisë *vetting*, por dhe në DIPP-në e vitit 2012 nuk deklaroi pakësim likuiditeti apo *cash* të mbartur në vite, pretendimi i subjektit nuk qëndron.*

**15.20.** Në vlerësimin e trupit gjykues, ashtu si dhe sipërtrajtuar në analizimin e shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, vlerësohet i drejtë qëndrimi i Komisionit lidhur me analizën e periudhës 01.01.2012-25.09.2012, duke konsideruar: (i) vlerën e apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, 50.000 euro, sipas deklaratës noteriale të datës 04.06.2012 ose ekuivalenti prej 6.979.500 lekësh; dhe (ii) moskonsiderimi si të ardhura nga shitja e apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, me kontratë shitje të datës 30.07.2010, firmosur nga Q. H. e familjarët e tij me blerës B. R., ku subjekti nuk ka qenë palë.

**15.21.** Trupit gjykues, nga kontrolli i analizës financiare së pjeshme të subjektit të kryer nga Komisioni për periudhën 01.01.2012-25.09.2012, referuar akteve të dosjes, i rezultoi një diferencë negative prej (-) 6.735.490 lekësh, pra, një vlerë prej 49.753 lekësh më e madhe nga konkluzioni i Komisionit [ (-) 6.685.737 lekë], rezultat ky që vjen si pasojë e kombinimit të

---

<sup>28</sup> Në analizën e vitit 2012, subjekti ka konsideruar të ardhura prej 4.139.802 lekësh më shumë se Komisioni prej 2.998.192 lekësh [se ka konsideruar të ardhura nga shitja e apartamentit në lagjen “{\*\*\*}” (pjesën e mbetur nga vlere 3.345.117 lekë se 2.500 euro ekuivalentin prej 346.925 lekësh e ka konsideruar të marrë në vitin 2010); pasuri prej 2.367.029 lekësh më pak se Komisioni prej 4.706.899 lekësh [pasi ka konsideruar: (i) vlerën e apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, për vlerën prej 3.821.526 lekësh e të paguar në 2012 pjesën prej 3.474.601 lekësh se pjesa prej 2.500 eurosh ose ekuivalenti prej 346.925 lekësh ishte konsideruar i paguar në vitin 2010; dhe (ii) ka konsideruar likuiditetin *cash* gjendje 40.000 lekë apo të pakësuar prej 1.202.000 lekësh dhe shpenzime prej 1.177.192 lekësh, njësoj me Komisionin.

Ilogaritjeve, konkretisht, të ardhurat nga paga e subjektit janë llogaritur më pak<sup>29</sup>, ndërsa shpenzimet jetike më shumë<sup>30</sup>. Në kushtet e mospërkeqësimit të situatës së subjektit, si dhe duke konsideruar faktin se subjekti nuk ka ankimuar të ardhurat apo shpenzimet e jetesës në këtë analizë, trupi gjykues konfirmon përfundimin e Komisionit se për analizën e mundësisë së krijimit të apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, për analizën pjesore 01.01.2012-25.09.2012, subjekti rezulton me diferencë negative prej (-) 6.685.737 lekësh.

**15.22.** Pavarësisht konstatimit të mësipërm, në funksion të analizimit të shkakut të ankimit të subjektit të rivlerësimit, sipas së cilit, lidhur me të ardhurat e deklaruar dhe të përfituara nga shitja e pasurisë apartament ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, ka një vendim të formës së prerë nga Gjykata e Apelit Tiranë që ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilin është vendosur deklarimi i pafajshëm i të pandehurit Petref Asllani për veprën penale “*Refuzimi për deklarim, mosdeklarim, fshehja ose deklarimi i rremë ia pasurisë, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose çdo personi tjetër që ka detyrimin për deklarim*”, të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, trupi gjykues, megjithëse lidhur me vendimmarrjen e gjykatave dhe parimin e gjësë së gjykuar ka mbajtur qëndrim më lart në këtë vendim, në pjesën ku janë analizuar aspektet procedurale të pretendimeve të subjektit, për një qëndrim garantist të situatës financiare të subjektit, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj kreu përlllogaritjen duke konsideruar si burim për apartamentin e ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, të ardhurën nga shitja e apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, sipas kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 30.07.2010, ku shtetasi Q. H. dhe familjarët e tij i shesin shtetasit B. R., apartamentin me sip. 68,29 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit prej 3.345.117 lekësh. Trupi gjykues konstaton se edhe në këtë variant të analizës financiare sërish subjekti rezulton me diferencë negative prej (-) 3.340.620 lekësh (3.345.117 lekë, më pak nga analiza e Komisionit).

**15.23.** Në përfundim, trupi gjykues e vlerëson të bazuar konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e pasurisë apartament të ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion mbetet i njëjtë edhe në versionin garantist të konsiderimit si burim të çmimit të shitjes së pasurisë në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan.

**15.24.** Trupi gjykues, në funksion të analizimit të mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për blerjen e pasurisë apartament të ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, me sip. 68,29 m<sup>2</sup>, verifikoi mënyrën e përfitimit të saj, si dhe transaksionet e kryera me të deri në momentin e blerjes nga subjekti i rivlerësimit, ku nga aktet e administruara në dosjen e ILDKPKI-së<sup>31</sup> dhe në Komision rezulton si vijon:

---

<sup>29</sup> Shuma prej 810.882 lekësh (më pak prej 45.326 lekësh) nga sa konsideruar nga Komisioni prej 856.208 lekësh, në Kolegj janë konsideruar sipas kalimeve në llogari në Credins Bank, ndërsa Komisioni ka konsideruar nga totali i vitit me përpjesëtim për 9 muaj.

<sup>30</sup> Shuma prej 423.072 lekësh më shumë prej 4.428 lekësh nga Komisioni që ka konsideruar prej 418.644 lekësh, në Kolegj janë konsideruar sipas shkresës së dërguar nga ILDKPKI në Kolegj nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2019, me burim nga të dhëna nga INSTAT në tabelën përmbledhëse në shkresë (faqja 7) për familje me “4 familjarë” në vitin 2012 shpenzimet janë 564.096 lekë në vit (ose 47.008 lekë/muaj për 4 familjarë shumëzuar për 9 muaj rezulton 423.072 lekë).

<sup>31</sup> Shih aktet në aneksin nr. {\*\*\*}, nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*}, në dosjen e ILDKPKI-së.

15.24/a. Në datën 01.08.2000, me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., apartamenti i ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, është blerë nga shtetasi A. K. për çmimin 400.000 lekë, i cili pas 3 (tre) ditëve në datën 4.8.2000, me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., ia ka shitur subjektit të rivlerësimit me çmimin 300.000 lekë, paguar në dorë jashtë zyrës noteriale. Sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor, datë 11.09.2000, kjo pasuri rezulton e regjistruar në pronësi të subjektit Petref Asllani. Komisioni ka analizuar çmimin e blerjes së apartamentit me sip. 68,29 m<sup>2</sup>, duke e krahasuar me çmimin referues të EKB-së të përcaktuar në vendimin e vitit 2000<sup>32</sup>. Duke llogaritur sipërfaqen 68,29 m<sup>2</sup> x 44.790 lekë/m<sup>2</sup>, sipas çmimeve të EKB-së për këtë apartament, rezulton se vlera është 3.058.709 lekë, ndërsa vlera e kontratës së blerjes nga subjekti është 300.000 lekë.

**15.24/b.** Me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*}, datë 27.07.2001, apartamentin e mësipërm subjekti ia ka shitur EKB-së Elbasan, në çmimin 2.258.000 lekë (pra, disa herë më shtrenjtë) dhe, sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore<sup>33</sup> të datës 27.07.2001, pasuria rezulton e regjistruar në pronësi të EKB-së. Nuk rezulton të jetë vendosur barrë mbi pasurinë. Kjo pasuri nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën për vitin 2003, pasi siç vërehet, edhe pse është shitur në vitin 2001, ka vijuar të deklarohet si adresë banimi në DIPP-të që prej vitit 2003 deri në vitin 2010 dhe, gjithashtu, është deklaruar si adresë e gjendjes civile deri në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe DIPP-në e vitit 2016<sup>34</sup>. Sa i takon mënyrës se si është likuiduar çmimi i shitjes, rezulton se me mandatpagesën e datës 02.08.2001 të Bankës së Kursimeve, EKB-ja Elbasan ka paguar në favor të subjektit shumën prej 2.258.000 lekësh, me përshkrimin “*Blerje në tregun e lirë*”. Ndërkohë, në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim në vitin 2003, subjekti ka deklaruar: *gjendje cash në banesë në shumën 3 milion lekë, me burim nga shitja e apartamentit*.

**15.25.** Nga analizimi i kontratave të mësipërme, në mënyrë të përmbledhur, konstatohet se shitësi A. K. ia ka shitur subjektit të rivlerësimit apartamentin 25 % më lirë se shuma që kishte paguar vetë vetëm 3 ditë më parë, ndërkohë që e ka blerë apartamentin për 400.000 lekë, ia shet subjektit në vlerën 300.000 lekë, pra, rreth 2.5 herë më lirë se blerësi i mëparshëm, i cili e kishte blerë në vitin 1994 për 10.300 USD<sup>35</sup> ose 1.028.867 lekë. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk i di arsyet se përse shitësi A. K. e ka shitur këtë apartament më lirë nga sa e kishte blerë, pasi ai nuk kishte asnjë njohje me këtë shtetas.

**15.26.** Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues konstaton se çmimi i shitjes së këtij apartamenti në tregun e lirë në momentin e blerjes nga subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë 3.058.709 lekë ose rreth 10 herë më i lartë se çmimi që subjekti e ka blerë sipas kontratës së shitjes. Si rezultat i këtyre konstatimeve, vendosja e çmimeve në kontratat e shitblerjes të vlerave disa herë më të ulëta se edhe vetë çmimet referencë të EKB-së bie në kundërshtim me logjikën ekonomike në tregun e pasurive të paluajtshme. Trupi gjykues vëren se çmimi i shënuar në kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.08.2000, prej 300.000 lekësh nuk duket se është çmimi real i paguar nga subjekti i rivlerësimit, për rrjedhojë e vlerëson të drejtë qëndrimin e

<sup>32</sup> Vendim nr. {\*\*\*}, datë 14.07.2000, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banësive, dhe të koeficientit “k”, për vitin 2000.

<sup>33</sup> Aktet bashkëlidhur, si dhe shkresës që ASHk-ja Elbasan i ka dërguar subjektit nr. {\*\*\*} prot., datë 03.05.2024, të cilat subjekti i ka sjellë bashkëlidhur prapësimeve.

<sup>34</sup> Ndërsa, në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se ka banuar në këtë apartament nga muaji gusht 2000 deri në muajin shtator 2012, kur ka blerë apartamentin objekt verifikimi në lagjen “{\*\*\*}”.

<sup>35</sup> 10.300 dollarë x 99.8 = 1.028,867 lekë.

Komisionit se shuma prej 300.000 lekësh e blerjes së kësaj pasurie është një çmim fiktiv.

**15.27.** Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se në analizën financiare duhet të merret në konsideratë si çmim i paguar nga subjekti i rivlerësimit për apartamentin në muajin gusht të vitit 2000 e njëjta vlerë sa ka paguar EKB-ja për blerjen e pasurisë nga subjekti në muajin korrik të vitit 2001, pra, shuma prej 2.258.000 lekësh. Komisioni, në përfundim, nuk i është referuar vlerës së tregut sipas EKB-së prej 3.058.709 lekësh, por çmoi të konsiderojë minimalisht si vlerë të blerjes së pasurisë pikërisht shumën 2.258.000 lekë që subjekti përfitoi nga shitja e pasurisë në datën 27.07.2001.

**15.28.** Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se si burim për blerjen e apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, duhet të merret në konsideratë edhe shuma e dhuruar prej 300.000 lekësh nga vëllai i tij Q. A., trupi gjykues konstaton se në relacionin e dorëzuar bashkë me deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti deklaroi si burim krijimi të shumës prej 300.000 lekësh për blerjen e apartamentit të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Ndërsa në pyetësonin nr. 2, subjekti ka ndryshuar burimin, duke deklaruar se burimi i krijimit të vlerës 300.000 lekë, me të cilën është blerë apartamenti, është nga shitja e apartamentit<sup>36</sup> të ndodhur në pallatin {\*\*\*}, lagjja “{\*\*\*}”, Elbasan, nga vëllai i tij Q. A., me të cilin ishte në një familje të pandarë ekonomikisht, për rrjedhojë konstatohet se subjekti ka kryer deklarime kontradiktore lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie.

**15.29.** Ndërsa sa i përket deklaratës noteriale<sup>37</sup> të shtetasit Q. A. (vëllai i subjektit), i cili deklaroi se: *Deri në vitin 2000 ai me vëllain ka jetuar si një familje e vetme në një ekonomi të përbashkët me prindërit. Në vitin 1996 me kontributin e përbashkët të familjes kanë blerë në qytetin e Elbasanit, në lagjen “{\*\*\*}”, në pallatin {\*\*\*}, një apartament banimi, i cili u regjistrua në emrin e tij (Q. A.), por në të banoi familja e Petref Asllanit deri në vitin 2000, kur kjo hyrje u shit në shumën 400.000 lekë, shumë të cilën ne si familje ia dhamë subjektit për të blerë një apartament në lagjen “{\*\*\*}”, pallatin {\*\*\*}, Elbasan. Gjithashtu, me shkëputjen nga trangu, nga kontributi në vite i dhanë edhe një shumë të hollash prej 300.000 lekësh, trupi gjykues çmon se kjo deklaratë është hartuar gjatë procesit të rivlerësimit, nga një i afërm i tij (vëllai) dhe përmban të dhëna që shkojnë në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, për rrjedhojë ka një vlerë të kufizuar provuese.*

**15.30.** Sa i takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se në raportet familjare ndërmjet vëllezërve të pandarë ekonomikisht nuk nevojitet dokument për shumën e dhuruar, trupi gjykues vlerëson se, bazuar në pikën 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Gjithashtu, pika 7 e Udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të Inspektorit të ILDKPKI-së, detyron subjektin e rivlerësimit për deklarimin saktësisht dhe në mënyrë të plotë të pasurisë së tij dhe personave të lidhur për burimin në momentin e krijimit të saj, ku me burim, në këtë rast, përfshihet si origjina, pra, shkak apo veprimi i ligjshëm që passjell disponimin dhe të drejtat pronësore të pasurisë, ashtu edhe mjetet financiare që kanë shërbyer për krijimin e saj. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

<sup>36</sup> Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të deklarimeve të tij, ka paraqitur në Komision kontratë shitblerje, datë 28.07.2000, sipas së cilës vëllai i tij Q. A. ka shitur një apartament në vlerën 400.000 lekë, në Elbasan.

<sup>37</sup> Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.03.2022.

Nga sa më lart konkluduar, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion justifikues ligjor për përfitimin e shumës së dhuruar prej vëllait, të ardhura nga shitja e apartamentit të ndodhur në pallatin {\*\*\*}, lagjja “{\*\*\*}”, Elbasan, nga vëllai Q. A., të cilat më pas janë përdorur për blerjen e apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, pretendimet e tij, ashtu si edhe në Komision, mbeten në nivel deklarativ dhe të pambështetura në prova.

**15.31.** Në lidhje me mundësinë financiare të blerjes së apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, në analizën e kryer prej Komisionit në periudhën 01.07.1995 – 04.08.2000, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës nga 66% e të ardhurave në 30% e të ardhurave deri në vitin 1999, sikurse arsyeton në vendim [parag. 47. Analiza financiare<sup>38</sup>]. Por, kur ka konkluduar në vendim [parag.32.5 i vendimit], rezulton se Komisioni nuk e ka ndryshuar pamjaftueshmërinë financiare prej (-) 1.922.439 lekësh, duke e lënë të njëjtë ashtu si në rezultatet e hetimit administrativ. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit, lidhur me llogaritjen e shpenzimeve të jetesës, është i bazuar e, në këto kushte, në analizën e pjeshme 01.07.1995 - 04.08.2000, për mundësinë e blerjes së apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, diferenca negative e Komisionit duhet të korrigjohet, në atë masë sa ulen dhe shpenzimet e jetesës deri në vitin 1999, nga 66% e të ardhurave në 30% të të ardhurave. Pra, shpenzimet e jetesës nga 979.379 lekë llogariten 602.263 lekë [sa ka pretenduar subjekti], në total më pak 377.116 lekë.

**15.32.** Nga sa më lart, trupi gjykues nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, edhe duke korrigjuar shpenzimet e jetesës në këtë analizë, përsëri konstaton se balanca negative për pasurinë apartament në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, mbetet, por në ndryshim nga Komisioni që kishte llogaritur vlerën prej (-) 1.922.439 lekësh, kjo balancë ulet në vlerën prej (-) 1.545.322 lekësh.

## **16. Mbi analizën financiare**

**16.1.** Komisioni arriti në përfundimin se për periudhën kur subjekti ka qenë në detyrë, në vitet 1995 – 2016, ai dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme në shumën (-) 9.502.242 lekë, për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasuritë.

**16.2.** Subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën financiare të Komisionit duke kërkuar nga Kolegji që në analizën e tij financiare: (a) çmimi i blerjes së pasurisë apartament në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, në vitin 2000, të llogaritet në vlerën 300.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes dhe jo në vlerën 2.258.000 lekë sikurse e ka llogaritur Komisioni; (b) çmimi i blerjes së apartamentit në lagjen “{\*\*\*}” duhet të përlllogaritet në shumën 3.821.526 lekë dhe kjo shumë të përfshihet në analizë; (c) të përfshihen të ardhurat e siguruar nga shitja e apartamentit të vëllait Q. A., si dhe shuma e kursimeve prej 300.000 lekësh, dhuruar nga familja e origjinës; (ç) gjendja *cash* në fund të vitit 2003 duhet të përlllogaritet në shumën 742.000 lekë, aq sa kanë qenë kursimet nga të ardhurat deri në fund të vitit 2003; (d) gjendja *cash* në fund të çdo viti duhet të përfshihet sipas tabelës së paraqitur prej tij në prapësimet e dorëzuara në Komision;

---

<sup>38</sup> “[...] Ndërkohë, janë marrë në konsideratë pretendimet për shpenzimet e jetesës për periudhën deri në vitin 1999, duke pasqyruar në analizën e rishikuar vlerën e shpenzimeve për periudhën deri në vitin 2003 në shumën 1.929.695 lekë, nga 2.306.811 lekë që ishte në rezultatet e hetimit”.

(dh) shpenzimet e jetesës deri në vitin 1999 duhet të përfshihen në masën 30% të të ardhurave, pasi të ardhurat vjetore kanë qenë mbi 800 USD/vit.

**16.3.** Trupi gjykues, në funksion të analizimit të pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit sa i përket çmimeve dhe të ardhurave të përfituara nga pasuritë apartament ndodhur në lagjen “{\*\*\*}” dhe apartament në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, sqaron se ka analizuar dhe ka mbajtur qëndrim më lart në këtë vendim. Ndërsa, sa i përket pretendimeve të subjektit lidhur me llogaritjen dhe mënyrën e deklarimit të gjendjes *cash*, trupi gjykues analizon dhe vlerëson si vijon.

- Subjekti ka deklaruar në vitin 2003 gjendje *cash* në banesë 3.000.000 lekë me burim të ardhurat nga shitja e apartamentit.
- Në DIPP-të e viteve 2004 – 2009, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesa/pakësime të gjendjes *cash*.
- Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti deklaroi 250.000 lekë me burim “*Kursime nga paga si prokuror të mbajtura në shtëpi*”.
- Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti deklaroi përsëri 250.000 lekë me burim “*Kursime nga paga si prokuror të mbajtura në shtëpi*”.
- Në vitet 2012 dhe 2013, subjekti nuk deklaroi ndryshime të gjendjes *cash*.
- Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti deklaroi 700.000 lekë kursime nga të ardhurat e pagës *neto* si prokuror për vitin 2014.
- Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti deklaroi kursime *cash* në vlerën 350.000 lekë me burim “*Kursime nga të ardhurat e pagës neto si prokuror për vitin 2014*”.
- Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti nuk deklaroi ndryshime të gjendjes *cash*.
- Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime *cash*.

**16.3/a.** Subjekti i rivlerësimit gjatë shpjegimeve të dhëna në Komision ka shpjeguar se gjendjen *cash* në deklaratën e pasurisë *vetting* nuk e ka deklaruar për shkak të një gabimi material, gabim i konstatuar gjatë vitit 2020 dhe për të cilin në datën 13.03.2020 ka paraqitur kërkesë pranë ILDKPKI-së, duke deklaruar se gjendja *cash* në datën e dorëzimit të deklaratës *vetting* ka qenë në shumën 1.090.000 lekë. Subjekti ka paraqitur kërkesën drejtuar ILDKPKI-së, faqen e deklaratës *vetting* të korrigjuar, si dhe konfirmimin nga posta shqiptare të shkresës së paraqitur pranë ILDKPKI-së.

**16.3/b.** Në lidhje me gjendjen *cash*, subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në vitin 2015, ka deklaruar se në vitin 2012 ka shpenzuar të gjitha kursimet *cash* të krijuara në vite, si dhe arkëtimin e shumës *cash* nga shitja e apartamentit. Në fund të vitit 2013 ka pasur gjendje *cash* në shumën 40.000 lekë. Gjatë vitit 2014 ka deklaruar shtesë kursimesh *cash* në shumën 700.000 lekë dhe në vitin 2015 shtesë kursimesh *cash* në shumën 350.000 lekë, duke disponuar një gjendje të kursimeve *cash* në fund të vitit 2016 në shumën 1.090.000 lekë.

**16.3/c.** Nga aktet e dosjes rezultojnë se Komisioni, në analizën financiare në raportin e rezultateve të hetimit administrativ të përcjellë subjektit, e ka konsideruar likuiditetin e gjendjes *cash*, duke përlllogaritur vetëm shtesat e deklaruara, bazuar në faktin se subjekti nuk ka deklaruar pakësim likuiditeti *cash* ndër vite dhe, sipas kësaj llogaritje të Komisionit, subjekti duhej të kishte në

vitin 2016 likuiditet *cash* gjendje prej 4.550.000 lekësh<sup>39</sup>. Ndërsa pas prapësimeve të subjektit, Komisioni ka konsideruar lidhur me pretendimet e tij vetëm për gjendjen e likuiditetit *cash* më 31.12.2013, e cila ka qenë 40.000 lekë, referuar jo vetëm shpjegimeve të subjektit, por duke gjetur pasqyrim edhe në procesverbalin e mbajtur me inspektorët e ILDKPKI-së më datë 03.02.2015, i cili daton në një kohë kur nuk kishte filluar procesi i *vetting*-ut, por janë në kuadër të shpjegimeve të dhëna në organin kompetent, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, në mënyrë të pavarur nga procesi i rivlerësimit.

**16.4.** Trupi gjykues, pas leximit të deklaratave të interesave periodike vjetore dhe akteve në fashikuj e shpjegimeve të subjektit, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pakësim likuiditeti ndër vite. Gjithashtu, konstaton se subjekti ka deklarime të ndryshme dhe kontradiktore për likuiditetin *cash* për vitet 2010, 2011 e 2012, në raport me deklaramet në DIPP, sqarimet e dhëna në ILDKPKI dhe prapësimet e paraqitura në Komision. Konkretisht, në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 03.02.2015, ka shpjeguar se në datën 31.12.2010 ka gjendje 992.000 lekë (742.000+250.000 lekë) e në prapësime në faqen 12, në tabelë në vitin 2010, vendos gjendje e akumuluar 250.000 lekë e, nga ana tjetër, në tabelën e analizës financiare (faqe 13), vendos vlerën prej 992.000 lekësh. Për vitin 2011, në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 03.02.2015, subjekti ka shpjeguar se në datën 31.12.2011 ka pasur gjendje 1.242.000 lekë (742.000+250.000+250.000 lekë) e në prapësime në faqen 12, në tabelë në 2011, vendos gjendje e akumuluar 500.000 lekë, ndërsa në tabelën e analizës financiare (faqe 13) vendos vlerën prej 1.242.000 lekësh. Për vitin 2012, në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 03.02.2015, subjekti ka deklaruar se kishte gjendje kursimesh prej 415.591 lekësh, në prapësime në faqen 12, në tabelë në vitin 2012 (e vitin 2013 e deklaroi së bashku), vendos gjendje e akumuluar 40.000 lekë, po ashtu edhe në tabelën e analizës financiare (faqe 13) vendos vlerën prej 40.000 lekësh.

**16.5.** Nga situata faktike rezultuar më lart, trupi gjykues, në kushtet e ekzistencës së kontradiktave dhe paqartësive të përsëritura në deklarime të subjektit, e vlerëson të pabazuar pretendimin e tij se gjendja *cash* në fund të çdo viti të konsiderohet bazuar në sqarimet dhe faktet e paraqitura prej tij, sipas tabelës së paraqitur në prapësime. Për rrjedhojë, qëndron konkluzioni i Komisionit se likuiditeti *cash* ndër vite është sipas deklarameve në DIPPtë përkatëse e vetëm në vitin 2013 gjendja e likuiditetit *cash* prej 40.000 lekësh, si shpjeguar në procesverbalin e ILDKPKI-së në datën 03.02.2015 dhe në prapësime. Trupi gjykues çmon se dispozitat ligjore, lidhur me detyrimin për deklarimin e shtesave/pakësimit të gjendjes *cash*, nuk lënë vend për konfuzion, pasi referuar legjislacionit në fuqi për deklarimin e pasurive dhe interesave privatë, subjektet deklaruese në deklarimin periodik të tyre duhet të deklarojnë shtesat dhe pakësimet në pasuritë e tyre, krahasuar me deklarimin e mëparshëm. Përveç përcaktimit shprehimisht të objektit të deklarimit në nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, në DPV-në e vitit 2012, në rubrikën “Deklarimi i interesave privatë”, jepen shpjegime të qarta

---

<sup>39</sup> Në DPV-në 2003, subjekti ka deklaruar: “Gjendje *cash* në banesë, nga shitja e apartamentit. Vlera: 3.000.000 lekë”. Deri në vitin 2009, po me këtë balancë, rezultoi se nuk ka deklaruar ndryshime likuiditeti *cash* në vite. Në vitin 2010 ka një shtesë prej 250.000 lekësh, pasi ka deklaruar gjendje prej 3.250.000 lekësh. Në vitin 2011 shtesë prej 250.000 lekësh, pasi ka deklaruar gjendje prej 3.500.000 lekësh. Në vitet 2012 e 2013 gjendje prej 3.500.000 lekësh, nuk ka deklarim lidhur me likuiditetin *cash*. Në vitin 2014 shtesë prej 700.000 lekësh, pasi ka deklaruar, gjendje prej 4.200.000 lekësh. Në vitin 2015 shtesë prej 350.000 lekësh, pasi ka deklaruar gjendje prej 4.550.000 lekësh. Në vitin 2016 gjendje prej 4.550.000 lekësh, nuk ka deklaruar lidhur me likuiditetin *cash*.

se në deklaram duhet të pasqyrohen shtesat dhe ndryshimet e interesave pasurore, përfshirë gjendjen *cash*, llogari rrjedhëse, depozitë etj.

**16.6.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në vitin 2003 gjendja *cash* ka qenë 742.000 lekë, trupi gjykues konstaton se subjekti në prapësimet e dorëzuara në Komision paraqet vlera të ndryshme, pasi në faqen 12 në tabelë për vitin 2003 vendos gjendje e akumuluar “0” (zero) e nga ana tjetër në narrativë<sup>40</sup> dhe tabelën e analizës financiare (faqe 13) vendos vlerën prej 742.000 lekësh, ashtu si dhe në shpjegimet e dhëna në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 03.02.2015. Pretendimi i subjektit për konsiderimin e shumës prej 742.000 lekësh si gjendje *cash* në vitin 2003 është i pabazuar, pasi në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003, subjekti deklaroi në mënyrë të qartë se shuma e kursyer është 3.000.000 lekë. Ky vlerësim bazohet edhe në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit.

**16.7.** Trupi gjykues konstaton se në DIPP-në e vitit 2012 subjekti nuk ka deklaruar pakësim likuiditeti në *cash* me qëllim blerjen e pasurisë apartament me sip. 77,8 m<sup>2</sup>, në lagjen “{\*\*\*}” dhe as të ardhura nga shitja e apartamentit të mëparshëm në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, prej 2.258.000 lekësh. Për rrjedhojë, në kushtet kur të ardhurat e deklaruara nuk mbulojnë nga burime të ligjshme, në përputhje me kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, ato nuk mund të shërbejnë si burim krijimi për mbulimin e shpenzimeve apo krijimin e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme, në vitet e mëpasshme, në kuptim të ligjshmërisë së tyre.

**16.8.** Nga analizimi i vendimit të Komisionit, trupi gjykues konstaton se në përlogaritjet e kryera prej Komisionit, edhe në një qëndrim garantist në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nëse në analizën financiare të rishikuar do të merreshin në konsideratë pretendimet sa i takon çmimit të blerjes së apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, në vitin 2001, në vlerën 300.000 lekë, si dhe pretendimet në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie, duke i konsideruar ato si burim për blerjen e pasurisë në lagjen “{\*\*\*}”, në vitin 2012, në vlerën 50.000 euro, si dhe duke konsideruar pretendimin e subjektit për gjendjen e likuiditetit *cash* në vitin 2003 në shumën 742.000 lekë, pakësimin e likuiditetit të gjendjes *cash* në vitin 2012, rezultati do të ishte me një balancë negative të burimeve të ligjshme në shumën (-) 2.838.429 lekë. Kjo balancë nuk lejon aplikimin për zbatim të parimit të proporcionalitetit.

**16.9.** Bazuar në situatën faktike të paraqitur më lart, trupi gjykues, nëpërmjet Njësisë Ligjore në Kolegj, kontrollon analizën financiare të Komisionit dhe i rezultoi se:

**16.9/a.** Për analizën financiare deri në vitin 2003, nga kontrolli i akteve, në ndryshim nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit rezulton me diferencë negative prej (-) 1.862.940 lekësh<sup>41</sup>, më pak se prej 377.431 lekësh nga konkluzioni i Komisionit [(-) 2.240.371 lekë]. Ky ndryshim

---

<sup>40</sup> Shprehet se: “Sikurse e sqarova, në deklaratën e vitit 2003 gjendja faktike e *cash*-it ka qenë në shumën 742.000 lekë”.

<sup>41</sup> Si diferencë e të ardhurave prej 5.340.150 lekësh (më shumë se Komisioni prej 392.826 lekësh), duke zbritur shpenzime prej 1.945.090 lekësh (më shumë se Komisioni prej 15.395 lekësh), duke zbritur dhe pasuri prej 5.258.000 lekësh njësoj sa Komisioni.

vjen si rezultat i përlogaritjes së të ardhurave nga paga e subjektit më shumë<sup>42</sup> dhe shpenzimeve jetike më pak<sup>43</sup>, si dhe duke konsideruar si shpenzim pagesën e tatimit prej 1% (mandatarkëtimi nr. {\*\*\*}, datë 27.07.2001)<sup>44</sup>. Në këtë analizë: (i) vlera e apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, është llogaritur sipas vlerës 2.258.000 lekë, aq sa subjekti ia ka shitur EKB-së; (ii) konsiderimi i likuiditetit *cash* prej 3.000.000 lekësh, sa është deklaruar në DPV-në 2003; dhe (iii) moskonsiderimi si të ardhura i shumës prej 300.000 lekësh, pretenduar si e dhuruar nga vëllai.

**16.9/b.** Për analizën financiare të vitit 2012, nga kontrolli i akteve, në ndryshim nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit rezulton me një diferencë negative prej (-) 7.115.414 lekësh<sup>45</sup>, më shumë prej 5.904 lekësh nga konkluzioni i Komisionit [(-) 7.109.510 lekë], pasi në Kolegj janë llogaritur shpenzime jetike në vlerën prej 564.096 lekësh, ndërsa Komisioni ka konsideruar vlerën prej 558.192 lekësh, pra, 5.904 lekë më pak<sup>46</sup>. Gjithashtu, u krye analiza për vitin 2012, edhe në versionin garantist, sikurse arsyetuar më lart në këtë vendim, duke konsideruar si burim për blerjen e apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, edhe të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan. Nga kjo përlogaritje, subjekti i rivlerësimit rezulton me diferencë negative prej (-) 3.770.297 lekësh<sup>47</sup>, më pak se prej 3.339.213 lekësh nga konkluzioni i Komisionit [(-) 7.109.510 lekë].

**16.9/c.** Për analizën financiare të vitit 2014, nga kontrolli i akteve, subjekti i rivlerësimit rezulton me diferencë negative prej (-) 136.018 lekësh<sup>48</sup>, më pak se prej 16.343 lekësh nga konkluzioni i Komisionit [(-) 152.360 lekë].

**16.9/ç.** Në total për të gjithë periudhën, sipas kontrollit referuar shkaqeve të ankimit, por edhe evidentimit të disa ndryshimeve në elementët e analizës nga kontrolli në Kolegj, diferenca negative e subjektit të rivlerësimit rezulton në vlerën prej (-) 9.114.372 lekësh<sup>49</sup>, në ndryshim nga konkluzioni i Komisionit [(-) 9.502.242 lekë], pra, më pak se prej 387.871 lekësh nga

---

<sup>42</sup> Shuma prej 3.082.150 lekësh, më shumë prej 392.826 lekësh, pasi Komisioni nuk ka konsideruar në analizën deri më 31.12.2003 të ardhurat nga muaji gusht 1995 - maj 1998, që në analizën e pjesshme që ka kryer deri më 04.08.2000 i kishte konsideruar, ndërsa në analizën deri më 31.12.2003 (duket se si lapsus) nuk i ka konsideruar në shumatoren e vlerës.

<sup>43</sup> Shuma prej 1.922.510 lekësh, më pak se prej 7.185 lekësh nga Komisioni që ka konsideruar prej 1.929.695 lekësh, diferenca vjen për të ardhurat nga gusht 1995 - maj 1998, sipas llogaritjeve në Kolegj janë më pak prej 22.217 lekësh dhe shpenzimet me 30% janë më pak respektivisht. Për shpenzimet e viteve 2000-2003 janë konsideruar sipas ILDKPKI-së me burim INSTAT-it.

<sup>44</sup> Shuma që subjekti ka paguar pas shitjes së apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan, EKB-së sipas kontratës datë 27.07.2001 prej 2.258.000 lekësh duke paguar tatimin prej 1% sipas mandatarkëtitimit nr. {\*\*\*}, datë 27.07.2001 (bashkëlidhur akteve që AShK i ka dërguar subjektit me nr. {\*\*\*} prot., datë 03.05.2024, sjellë nga subjekti bashkëlidhur prapësimeve).

<sup>45</sup> Si diferencë e të ardhurave prej 1.141.610 lekësh njësoj si Komisioni, duke zbritur shpenzime prej 1.183.096 lekësh (më shumë se Komisioni prej 5.904 lekësh), duke zbritur dhe pasuri prej 7.073.928 lekësh njësoj sa Komisioni.

<sup>46</sup> Në Kolegj janë konsideruar, sipas shkresës së ILDKPKI-së, me burim nga INSTAT, ardhur në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2019, e shpenzimet janë 564.096 lekë për familje me 4 persona (ose 141.024 lekë për person).

<sup>47</sup> Si diferencë e të ardhurave prej 4.486.727 lekësh, ndryshe nga Komisioni u përfshinë të ardhurat nga shitja e apartamentit në lagjen “{\*\*\*}”, duke zbritur shpenzime prej 1.183.096 lekësh (më shumë se Komisioni prej 5.904 lekë), duke zbritur dhe pasuri prej 7.073.928 lekë njësoj sa Komisioni.

<sup>48</sup> Ky ndryshim rezulton se të ardhurat nga paga e djalit janë llogaritur 74.817 lekë më shumë se Komisioni, i cili ka konsideruar vlerën 58.475 lekë, kjo mangësi duket se ka ardhur si pasojë se janë mbledhur gabimisht dy herë të ardhurat nga {\*\*\*} prej 21.223 lekësh, në vend që të mblidheshin të ardhurat nga {\*\*\*} prej 37.566 lekësh.

<sup>49</sup> Si total i diferencave negative: analiza deri më 31.12.2003 prej (-) 1.862.940 lekësh; viti 2012 me diferencë prej (-) 7.115.414 lekësh; viti 2014 me diferencë prej (-) 136.018 lekësh.

analiza e Komisionit. Ndërsa sipas versionit garantist rezulton për total diferencë negative në vlerën prej (-) 5.769.255 lekësh<sup>50</sup>.

**16.10.** Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit për periudhën deri më 31.12.2003, për vitet 2012 dhe 2014, trupi gjykues, edhe pas konsiderimit të disa pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, përsëri konkludon se mbetet sërish balancë negative për këto vite. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe për të justifikuar plotësisht shpenzimet, situatë kjo që kualifikohet sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

**17.** Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm e, për rrjedhojë, është i pabesueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke u gjendur në këtë mënyrë në një prej rasteve të parashikuara nga ligji për vendosjen e masës disiplinore shkarkim nga detyra. Për sa më lart, vendimi nr. 761, datë 14.05.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 761, datë 14.05.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Petref Asllani.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm

U shpall, në Tiranë, më datë 14.01.2026.

#### **ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

#### **ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUESE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

---

<sup>50</sup> Si total i diferencave negative: analiza deri më 31.12.2003 prej (-) 1.862.940 lekësh; viti 2012 me diferencë prej (-) 3.770.297 lekësh; viti 2014 me diferencë prej (-) 136.018 lekësh.